



PLANIFIKIMI ME PJESËMARRJE

PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË PEJËS, GJAKOVËS, DEÇANIT, ISTOGUT, KLINËS DHE JUNIKUT



PLANIFIKIMI ME PJESËMARRJE

***PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË PEJËS,
GJAKOVËS, DEÇANIT, ISTOGUT, KLINËS DHE JUNIKUT***

Prishtinë, 2010



PËRMBAJTJA

Rreth ATRC-së	5
Rreth projektit	6
Komuna e Pejës	7
Komuna e Gjakovës	26
Komuna e Deçanit.....	36
Komuna e Istogut.....	43
Komuna e Klinës	51
Komuna e Junikut	62

RRETH ATRC-së

Advocacy Training and Resource - ATRC është organizatë Kosovare jo-fitimprurëse e cila angazhohet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje, si parakusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike. ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngritë kapacitetin e OJQ-ve dhe iniciativave qytetare që të ndërmarrin kampanja avokimi dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse që i takojnë standardeve ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativave qytetare, administratës publike, institucioneve politike, mediave, etj, pavarësisht nga bindjet dhe përkatësitë politike, fetare, etnike, etj.

Që nga themelimi i saj në vitin 2001, ATRC ka ndihmuar numër të madh të OJQ-ve në Kosovë duke synuar ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizimin në punën e tyre, krijimin dhe artikullimin e kërkesave të tyre dhe pajisjen me aftësi avokuese në strukturat e qeverisë në lidhje me çështjet që preokupojnë shoqërinë kosovare.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes katër programeve kryesore të saj:

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të rrisë kapacitetin e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit organizativ, menaxhimit të projekteve dhe në avokim.
2. Programi i administrimit të Granteve, i cili synon të ndihmojë organizatat joqeveritare lokale përmes granteve kryesisht në avokim.
3. Programi për Avokim, përmes projekteve të ndryshme ATRC synon të avokoj në institucione nacionale dhe lokale për probleme të ndryshme të cilat janë preokupim dhe brengë e qytetarëve në përgjithësi.
4. Informimit, me të cilin ATRC synon të ofroj informacione në mënyrë elektronike përmes informacioneve të freskëta në ueb faqe, diskutime publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ndërtim koalicioni, ndërmjetësim partneriteti dhe bashkëpunimi. ATRC gjithashtu ofron librari me botime për çështjet sociale, politike dhe ekonomike që lidhen me Kosovën dhe rajonin.


RRETH PROJEKTIT

Advocacy Training and Resource Center – ATRC me mbështetje financiare nga The Olof Palme International Center, me përkrahje nga Komunitetet e regjionit të Pejës: Pejë, Gjakovë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik dhe në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të Bashkësive Lokale, Zyrtarë të Vendi, përfaqësues të fshatrave dhe qytetarë, në kuadër të projektit “Zgjidhja e Konfliktit Social”, ka identifikuar nevojat e banorëve të regjionit të Pejës për vitin 2011-2012.

Projekti “Zgjidhja e Konfliktit Social” ka për qëllim të ndihmojë qeverisje lokale dhe shoqërisë civile të nxisë dhe forcojë marrëdhëniet në mes tyre në mënyrë që të parashikojë dhe të përgjigjet më mirë nevojave të komunitetit duke avancuar marrëdhëniet në mes tyre dhe duke shfrytëzuar mjetet dhe teknikat për zgjidhjen e konflikteve.

Gjatë këtij viti ATRC ka synuar që të rris bashkëpunimin në mes Kuvendeve Komunale dhe qytetarëve; t’i ofroj mundësinë qytetarëve të regjionit që të shprehin lirshëm kërkesat dhe rekomandimet e tyre dhe të ushtrojnë presionin demokratik në institucionet lokale për marrjen në konsideratë të kërkesave të tyre gjatë hartimit të planeve komunale; si dhe të ndihmoj Kuvendet komunale në procesin e hartimit të buxhetit komunal, duke i ofruar të dhëna konkrete për secilin fshat veç e veç.

KOMUNA E PEJËS



Harta e qytetit

Karakteristikë e përgjithshme e pozitës së Pejës është se ajo shtrihet në skajin veriperendimor të luginës së pllëshme të Dukagjinit, para grykës piktoreske, nën shpatet e Alpeve shqiptare (Albanian Alps). Qyteti i Pejës është i vendosur në teracën neogjene aluviale në lartësi mbidetare 505-520m. Ky qytet ngritet në fushën e rrafshit të Dukagjinit dhe rrenzë bjeshkëve të larta. Peja në pikpamje gjeomorfologjike përbën një tërsi ekonomike dhe në vete ruan e kultivon traditë të një historie të lashtë. Peja lidhet me qarkullimin rrugor me Prishtinën, Mitrovicën, Gjakovën, Rozhajën e Plavën.

Qyteti është i rrethuar me Bjeshkët, që janë pjesë e masivit dinamika që përfshinë tërë Ballkanin prëndimorë. Këto bjeshkë formojnë një kurorë majesh të larta siç janë: maja e Kopranikut (2460m), Mali Zhlep (2352 m), Hajlën (2460 m) Mokra (1932m), malet e Lumbardhit gjegjësisht Guri i Verdhë (2522m), maja e Viellakut (2012m), Peklena, maja e Hasanit etj. Me rrjedhë të shpejtë grykës shkëmbore të Rugovës, lumi “Lumbardhi” fillon të gjarpron fushës së Pejës, duke kaluar në mes të qytetit dhe duke e ndarë në dy pjesë. Lumbardhi i cili gjatë rrjedhjës formon fusha pjellore, derdhet në lumin më të madh të qujtur ‘ “ Drini i Bardhë” që buron nga bjeshkët e Zhlepit në fshatin Radac. Malet e Pejës janë të pasur edhe me liqenjë si: Liqeni i Niçinatit dhe Liqeni i Ridit.

Komuna e Pejës ka 603 km² dhe kufizohet me: Istogun, Klinën, dhe Deçanin. Kurse, me komunën e Plavës, Beranës dhe Rozhajës kufizohet me Malin e Zi dhe në anën tjetër kufizohet me Republikën e Shqipërisë. Brenda kufive administrativ të Komunës së Pejës ka 97 vendbanime të organizuara në 28 bashkësi territoriale, nga të cilat 13 Bashkësi Territoriale në qytet: B.T.”Sahat Kulla”, “Qendra”, “2 Korriku”, “Kapeshnica”, “Karagaqi”, “Haxhi Zeka”, “Xhemajl Kada”, “Rrokaqielli”, “Kristali”, “7 Shtatori”, “Dardania I”, “Dardania II”, dhe “Dardania III” dhe 14 Bashkësi Territoriale në fshatra: B.T. Baran”, Gllogjan, Kryshec, Poqestë, Raushiq, Leshan, Zahaq, Nabergjan, Trestenik, Treboviq, Vitomiricë, Radavc, Osdrim dhe Rugovë. Peja para vitit 1999 ka patur 181.130 banorë.

PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË PEJËS

Bashkësia Teritoriale “Sahat Kulla”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale është e mirë. Rrugët kryesore janë të asfaltuara, veç rrugës që lidhet me Majën e Zezë e cila nuk është e asfaltuar;
- ❖ Bashkësia Teritoriale “Sahat Kulla” ka dy shkolla fillore dhe gjimnazin. Kushtet për zhvillimin e mësimin në shkolla janë të mira;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale gjithashtu është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka një Q.M.F – Qendër të mjekësisë familjare dhe gjithashtu Spitalin regional;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Sahat Kulla”

1. Të asfaltohet rruga për Majën e Zezë.

Bashkësia Teritoriale “Qendra”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale është e mirë. Rrugët janë të asfaltuara, megjithatë shumica e rrugëve janë të ngushta dhe nuk kanë trotuar;
- ❖ Bashkësia Teritoriale “Qendra” ka një shkollë fillore si dhe shkollën e ulët dhe të lartë të muzikës;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e kanalizimit, veç lagjes “Enver Hadri” e cila nuk është e lidhur me këtë rrjet. Ujërat e zeza të kësaj lagje derdhen në prrockën Qokolica;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka një Q.M.F – Qendër të mjekësisë familjare, e cila është ndërtuar këtë vit nga Komuna dhe Ministria e Shëndetësisë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Qendra”

1. Të zgjerohen rrugët dhe të rregullohen trotuaret. Banorët dhe sidomos nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet.

2. Të ndalet zhurma nga lokalet e natës.
3. Të rregullohet prrocka Qokolica, sepse shpeshherë ka vërshime.
4. Të ndalohet ndërtimi i objekteve shumëkatëshe dhe i mbindërtimeve, shumica e të cilave janë pa leje.
5. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në lagjen “Enver Hadri”.
6. Të intervenohet në ndërtimin e pendës në lumin Bistrica.

Bashkësia Teritoriale “2 Korriku”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale nuk është e mirë. Gjendja më e keqe është në 4 lagje, rrugët e të cilave nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia Teritoriale “2 Korriku” nuk ka shkollë fillore. Nxënësit e kësaj Bashkësie teritoriale vijnë në mësimin në shkollën fillore të Bashkësisë teritoriale “Sahat kulla”;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Megjithatë, një lagje nuk ka furnizim të rregullt me ujë;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e kanalizimit, megjithatë ky rrjet është dëmtuar dhe ka disa muaj që ujërat e zeza derdhen në rrugë;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale nuk ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen pjesërisht nga komuna. Mbeturinat mblidhen vetëm në kontenjerë, ndërkohë që në këtë Bashkësi teritoriale hudhen mbeturinat në dy shtëpi të vjetra dhe nuk largohen nga aty.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “2 Korriku”

1. Të rregullohet furnizimi me ujë në një lagje të Bashkësisë teritoriale.
2. Të asfaltohen 4 rrugët e kësaj Bashkësie teritoriale.
3. Të ndërtohet një çerdhe e fëmijëve. Banorët kanë bërë kërkesë në Komunë dhe parcela për ndërtimin e çerdes gjithashtu ekziston, megjithatë deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë.
4. Të pastrohen mbeturinat në dy shtëpitë e vjetra.
5. Të bëhet ndriqimi i lagjeve.



Pamje nga qyteti

Bashkësia Teritoriale “Haxhi Zeka”

Bashkësia Teritoriale Haxhi Zeka ka rreth 25 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale është e mirë. Rrugët janë kryesisht të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia Teritoriale “Haxhi Zeka” ka një shkollë fillore dhe një paralele të ndarë të kësaj shkolle;
- ❖ Bashkësisë Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Bashkësisë Teritoriale është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Haxhi Zeka”

1. Të rregullohen trotualet në rrugët e kësaj Bashkësie teritoriale.



Takim me përfaqësuesit e Shoqërisë civile dhe zyrtarët e Komunës së Pejës

Bashkësia Teritoriale “Rokaqielli”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale është e mirë. Veç rrugës te Qendra Zejtare që lidhet me Vitomiricë (rruga deri te Peja City) që nuk është në gjendje të mirë, rrugët tjera janë të asfaltuara,;
- ❖ Bashkësia Teritoriale “Rokaqielli” ka një shkollë fillore dhe gjithashtu në oborrin e kësaj shkolle është ndërtuar shkolla e mesme teknike, por e cila ende nuk është në funksion;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë banorët sidomos nga kati i dytë i ndërtesave kanë probleme me furnizimin e ujit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale nuk ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Rokaqielli”

1. Të rregullohen fasadat dhe oborret e ndërtesave. Fasadat dhe oborret e ndërtesave janë në gjendje shumë të keqe.
2. Të rregullohen kulmet e dy ndërtesave, të cilat janë në gjendje shumë të keqe.

Bashkësia Teritoriale “Zatra”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale është pjesërisht e mirë. Ndonëse rrugët kryesore janë kryesisht të asfaltuara, ka rrugë lokale që nuk janë të asfaltuara;

- ❖ Bashkësia Teritoriale “Zatra” ka një shkollë fillore. Megjithatë, shkolla është shumë e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimi;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë banorët ballafaqohen me mungesë të ujit. Mungesa e furnizimit me ujë në këtë Bashkësi teritoriale zgjat nga 3 deri në 7 ditë;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e kanalizimit, veç një pjese të vogël që nuk është e lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka një ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Zatra”

1. Të rregullohet furnizimi me ujë. Banorët të furnizohen me ujë të paktën nga 6 orë në ditë.
2. Të përmirësohen kushtet në shkollën fillore.
3. Të përfundohet asfaltimi i rrugëve.

Bashkësia Teritoriale “Xhemajl Kada”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale është e mirë. Megjithatë, disa rrugë si: “Ymer Basha” dhe “Sylë Hasani” nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia Teritoriale “Xhemajl Kada” ka një shkollë fillore;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë një pjesë e banorëve ballafaqohen me mungesë të ujit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e kanalizimit, megjithatë në disa lagje ku rrugët nuk janë të asfaltuara mungon edhe rrjeti i kanalizimit;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale nuk ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen pjesërisht nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Xhemajl Kada”

1. Të rregullohet furnizimi me ujë.
2. Të asfaltohen ose të kubëzohen rrugët dhe të vendoset rrjeti i kanalizimit në ato pjesë.

Bashkësia Teritoriale “Kristali”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale nuk është e mirë. Gjatë vitit 2010 janë asfaltuar dy rrugë, kurse rrugët tjera nuk janë të asfaltuara;

- ❖ Bashkësia Teritoriale “Kristali” ka një shkollë fillore, e cila është ndërtuar në vitin 2003;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë një pjesë e banorëve ballafaqohen me mungesë të ujit sidomos gjatë stinës së verës;
- ❖ Rrjeti i kanalizimit është vendosur para disa vitesh, por në këtë projekt nuk është përfshirë një pjesë e kësaj Bashkësie Teritoriale;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale nuk ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Kristali”

1. Të vazhdohet rrjeti i kanalizimit në tërë Bashkësinë teritoriale.
2. Të rregullohet furnizimi me ujë.
3. Të asfaltohen rrugët. Veç dy rrugëve të cilat janë të asfaltuara, gjendja e rrugëve të tjera nuk është e mirë.
4. Të bëhet ndriqimi i dy rrugëve të asfaltuara dhe i rrugëve të tjera gjithashtu.

Bashkësia Teritoriale “7 Shtatori”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale nuk është e mirë. Në gjendje më të keqe janë sidomos dy rrugë të kësaj Bashkësie teritoriale;
- ❖ Bashkësia Teritoriale “7 Shtatori” ka një shkollë fillore dhe një shkollë të mesme ekonomike. Megjithatë, banorët kanë nevojë që të ndërtohet edhe një shkollë e ciklit të ulët;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale ka probleme me rrjetin e kanalizimit. Ujërat e zeza sidomos gjatë reshjeve dalin në sipërfaqe;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen pjesërisht nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “7 Shtatori”

1. Të asfaltohen ose të të kubëzohen dy rrugë të Bashkësisë teritoriale.
2. Të rregullohet rrjeti i kanalizimit.
3. Të ndërtohet një shkollë e ciklit të ulët.

Bashkësia Teritoriale “Dardania I”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale është pjesërisht e mirë. Disa nga rrugët nuk janë të asfaltuara;

- ❖ Bashkësia Teritoriale “Dardania I” ka një shkollë fillore, e cila është ndërtuar para dy vitesh. Kushtet për zhvillimin e mësimin në shkollë janë të mira, megjithatë shkolla nuk ka rrethojë;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale nuk ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Dardania I”

1. Të lëshohet në qarkullim një linjë e transportit publik.
2. Të asfaltohen rrugët.
3. Të vendoset ndriqimi.
4. Të rregullohen trotualet, sepse banorët dhe në veçanti nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet.
5. Të vendoset rrethoja e shkollës.

Bashkësia Teritoriale “Dardania II”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale nuk është e mirë. Në gjendje më të keqe janë rrugët Ruzhdi Haxhiaj dhe Ardian Krasniqi;
- ❖ Bashkësia Teritoriale “Dardania II” ka një shkollë fillore, e cila është ndërtuar vitin e kaluar;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë sidomos gjatë stinës së verës furnizimi me ujë nuk është i rregullt;
- ❖ Bashkësia Teritoriale nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka një ambulancë, megjithatë kushtet në këtë ambulancë nuk janë të mira;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Dardania II”

1. Të asfaltohen rrugët Ruzhdi Haxhiaj dhe Ardian Krasniqi dhe gjithashtu të rregullohet trotuari në rrugën Ardian Krasniqi. Mungesa e këtij trotuari rrezikon nga automjetet veç banorëve edhe nxënësit.
2. Të renovohet ambulanca. Ambulanca është ndërtuar para vitit 1999 dhe është në gjendje shumë të keqe.
3. Të vendoset ndriqimi i rrugëve.

Bashkësia Teritoriale “Dardania III”

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Bashkësie Teritoriale nuk është e mirë. Në gjendje më të keqe janë dy rrugë: një rrugë e cila është e paasfaltuar dhe gjithashtu rruga kryesore e cila është asfaltuar në vitet e 80-ta por e cila është dëmtuar;
- ❖ Bashkësia Teritoriale “Dardania III” ka një shkollë fillore;
- ❖ Bashkësia Teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale nuk ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale “Dardania III”

1. Të asfaltohet rruga kryesore dhe të paktën të shtrohet me zhavor një rrugë, e cila është në gjendje të keqe.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.

Bashkësia Teritoriale Leshan

Bashkësia Teritoriale Leshan përfshin 6 fshatra: Leshan, Gllaviqicë, Kliqinë, Jabllanicë, Cverk dhe Rosul. Kjo Bashkësi Teritoriale ka rreth 5 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Bashkësie Teritoriale nuk është e mirë. Veç fshatit Jabllanicë ku rruga kryesore është e asfaltuar, në asnjë fshat tjetër të Bashkësisë Teritoriale Leshan rrugët nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia Teritoriale Leshan ka 3 shkolla fillore të cilat ndodhen në fshatrat Kliqinë, Leshan dhe Gllaviqicë. Megjithatë, shkolla në Leshan nuk ka hapsirë të mjaftueshme dhe nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimi;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e kësaj Bashkësie teritoriale nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Banorët furnizohen me ujë përmes puseve individuale. Megjithatë, uji në puse është i ndotur nga ujërat e zeza, andaj një pjesë e banorëve bartin ujë nga qyteti;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit. Ujërat e zeza derdhen në gropa septike;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka një ambulancë në fshatin Leshan. Banorët e fshatrave të tjerë udhetojnë rreth 3 km. për të marrë shërbime mjekësore në këtë ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Leshan

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat e Bashkësisë Teritoriale.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat e Bashkësisë Teritoriale.
3. Të ndërrohen shtyllat elektrike, sepse rrjeti elektrik është shumë i vjetër.
4. Të asfaltohen rrugët në të gjitha fshatrat. Vetëm në fshatin Jabllanicë rruga kryesore është e asfaltuar.
5. Të ndërtohet një shkollë fillore në Leshan, sepse shkolla ekzistuese nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin.

Bashkësia Teritoriale Rugovë

Bashkësia Teritoriale Rugovë përfshin 15 fshatra: Shtupeq i vogël, Shtupeq i madh, Pepaj, Ujmirë, Drelaj, Malaj, Reka e Allagës, Kuqishtë, Haxhaj, Stakaj, Bogë, Shkrel, Dugaivë, Koshutan, Llaz e Bollapaqë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Bashkësie Teritoriale nuk është e mirë. Veç fshatrave Kuqishtë dhe Dugaivë ku rruga kryesore është e asfaltuar, në asnjë fshat tjetër të Bashkësisë Teritoriale Rugovë rrugët nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia Teritoriale Rugovë ka 2 shkolla fillore të cilat ndodhen në fshatrat Drelaj dhe Shtupeq i madh;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e kësaj Bashkësie Lokale nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, ndonëse të gjitha fshatrat veç fshatit Dugaivë kanë burime të ujit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit. Ujërat e zeza derdhen në gropa septike;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka dy ambulanca të cilat ndodhen në fshatrat Drelaj dhe Haxhaj, por megjithatë sidomos gjatë stinës së verës ato nuk funksionojnë rregullisht;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna deri në Bogaj, por banorët nuk janë të kënaqur me këtë shërbim.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Rugovë

1. Të asfaltohen rrugët në fshatra.
2. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat.
3. Të përcaktohen zonat turistike dhe zonat blegtorale.
4. Të investohet në zhvillimin e turizmit.



Bashkësia Teritoriale Raushiq

Bashkësia Teritoriale Raushiq përfshin 4 fshatra: Raushiq, Lubeniq, Zlopek dhe Loxhë. Kjo Bashkësi Teritoriale ka rreth 8 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Bashkësie Teritoriale është e mirë. Rrugët kryesore të fshatrave janë të asfaltuara, veç fshatit Raushiq ku rruga kryesore, rreth 1 km. e 200 m., nuk është e asfaltuar;
- ❖ Bashkësia Teritoriale Raushiq ka 4 shkolla fillore të cilat ndodhen në fshatrat Raushiq, Lubeniq, Zlopek dhe Loxhë. Megjithatë, shkolla në Raushiq është shumë e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin;
- ❖ Fshatrat e kësaj Bashkësie Teritoriale janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, veç një pjese të fshatit Zlopek i cili nuk është i lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit. Ujërat e zeza derdhen në gropa septike;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka një QMF – Qendër të mjekësisë familjare në fshatin Raushiq;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Raushiq

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat e Bashkësisë Teritoriale.
2. Të mblidhen mbeturinat nga komuna.
3. Të asfaltohet rruga, rreth 1 km. e 200 m, në Raushiq dhe rruga në fshatin Zlopek e cila rrugë lidhet me fshatin Loxhë.
4. Të punoj stomatologu në QMF - Qendrën e mjekësisë familjare.
5. Të investohet në rrjetin elektrik në Raushiq, sepse ky rrjet është shumë i vjetër.
6. Të aprovohet lokacioni për varreza shtesë.
7. Të lidhet me rrugën e asfaltuar Lugu i Beranit

Bashkësia Teritoriale Zahaq

Bashkësia Teritoriale Zahaq përfshin 4 fshatra: Zahaq, Ramun, Llabjan dhe Nakëll. Kjo Bashkësi Teritoriale ka rreth 4 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Bashkësie Teritoriale është mesatarisht e mirë. Rrugët kryesore të fshatrave janë të asfaltuara, kurse rrugët lokale të fshatrave nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia Teritoriale Zahaq ka një shkollë fillore në fshatin Zahaq. Shkolla është renovuar kohët e fundit dhe kushtet për zhvillimin e mësimin janë të mira;
- ❖ Fshatrat Nakëll, Zahaq dhe një pjesë e fshatit Llabjan janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, kurse fshati Ramun nuk është i lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Bashkësi Teritoriale ka një QMF - Qendër të Mjekësisë Familjare në fshatin Zahaq;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna. Banorët në mënyrë individuale i dërgojnë mbeturinat në deponinë e qytetit.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Zahaq

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat e Bashkësisë Teritoriale.
2. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshatin Ramun dhe në një pjesë të fshatit Llabjan.
3. Të ndërtohet ura në mes të fshatrave Ramun – Poqestë.
4. Të ndërtohet fusha sportive. Parcela për fushë sportive është në fshatin Zahaq.
5. Të rregullohet rrjeti elektrik në lagjet Kelmend dhe Kastrat të fshatit Zahaq. Rrjeti elektrik është shumë i vjetër dhe paraqet rrezik për banorët.
6. Të vihet në funksion sistemi i ujitjes së tokave bujqësore, pasi shumica e banorëve mirren me bujqësi.
7. Të mblidhen mbeturinat.

Bashkësia Teritoriale Radavc

Bashkësia Teritoriale Radavc përfshin 4 fshatra: Radavc, Jabllanicë e Madhe, Jabllanicë e Vogël dhe Novosellë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të Bashkësisë Teritoriale Radavc është e mirë. Rrugët e fshatrave janë kryesisht të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia teritoriale ka dy shkolla fillore, të cilat ndodhen në fshatrat Novosellë dhe Jabllanicë e Vogël dhe gjithashtu në Novosellë është duke u ndërtuar një shkollë e re fillore. Megjithatë, në mungesë të trotuarit nxënësit e fshatit

Novosellë janë të rrezikuar nga automjetet, pasi nxënësit shkojnë në shkollë përgjatë magjistrales Pejë-Rozhajë;

- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por gjatë stinës së verës furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale ka dy ambulanca, të cilat ndodhen në fshatrat Novosellë dhe Radavc;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Radavc

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
2. Të ndërtohet një mbikalim në fshatin Novosellë, në magjistralen Pejë-Rozhajë, sepse banorët dhe në veçanti nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet.
3. Të përmirësohet furnizimi me ujë.
4. Të vendoset ndriqimi në fshatra.
5. Të vendoset sistemi i ujitjes së tokave bujqësore.
6. Të rindërtohet ambulanca në Radavc. Kjo ambulancë është në gjendje shumë të keqe.
7. Të renovohet shkolla fillore në fshatin Jabllanicë e Vogël.

Bashkësia Teritoriale Krushec

Bashkësia Teritoriale Krushec përfshin 3 fshatra: Krushec, Rashiq dhe Broliq, në të cilat jetojnë rreth 15 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të Bashkësisë Teritoriale Krushec është mesatarisht e mirë. Rruga Krushec-Broliq është e asfaltuar, kurse rruga në Rashiq nuk është e asfaltuar dhe është në gjendje të keqe. Gjithashtu, rrugët lokale të fshatrave nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia teritoriale ka një shkollë fillore në Krushec dhe dy shkolla të tjera katër vjeçare në fshatrat Rashiq dhe Broliq. Nxënësit e fshatrave Rashiq dhe Broliq nga klasa e pestë udhëtojnë nga 2-3 km., për të vijuar mësimin në fshatin Krushec. Gjithashtu, në mungesë të trotuarit nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet;
- ❖ Fshatrat Krushec dhe Broliq janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, kurse fshati Rashiq nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Fshati Rashiq është i lidhur me rrjetin e kanalizimit, kurse fshatrat Krushec dhe Broliq nuk janë të lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Bashkësia Teritoriale Krushec ka një ambulancë, e cila ndodhet në fshatin Krushec;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Krushec

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshatrat Krushec dhe Broliq. Për zgjidhjen e kësaj çështjeje, banorët kanë bërë kërkesë dhe gjithashtu kanë dorëzuar projektin në Komunë.
2. Pas vendosjes së kanalizimit të asfaltohet rruga rreth 1 km. Krushec-Rashiq.
3. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshatin Rashiq.
4. Të ndërtohet një urë në fshatin Radavc.



Pamje nga qyteti

Bashkësia Teritoriale Baran

Bashkësia Teritoriale Baran përfshin 8 fshatra: Baran i ulët, Baran i epërm, Qollopek, Kamenicë, Vuçan, Vranoc, Kotradiq dhe Turjakë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të Bashkësisë Teritoriale Baran është mesatarisht e mirë. Rrugët kryesore të shumicës së fshatrave janë të asfaltuara, veç fshatrave Kotradiq dhe Turjakë ku rrugë kryesore nuk janë të asfaltuara dhe janë në gjendje mjaft të keqe. Gjithashtu, rrugët lokale të fshatrave nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia teritoriale ka një shkollë fillore në Baran dhe tri shkolla të tjera katër vjeçare në fshatrat Vranoc, Kotradiq dhe Vuçan. Shkolla në Vuçan është e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin dhe gjithashtu shkolla në Baran nuk ka hapsirë mjaftueshme. Megjithatë, në Baran është duke u shtuar një aneks i shkollës fillore. Një problem me të cilin ballafaqohen nxënësit e këtyre fshatrave është mungesa e trotuareve, gjë që paraqet rrezik nga automjetet;
- ❖ Veç fshatit Vranoc, ku banorët deri diku e kanë rregulluar vetë çështjen e ujësjellësit, asnjë nga fshatrat tjerë të Bashkësisë Teritoriale Baran nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;

- ❖ Vetëm fshatrat Baran i ulët dhe Vranoc janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit, kurse 6 fshatrat tjerë nuk janë të lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Bashkësia Teritoriale Baran ka një ambulancë, e cila ndodhet në fshatin Baran;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Baran

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshatrat: Baran i epërm, Qollopek, Kamenicë, Vuçan, Kotradiq dhe Turjakë.
3. Të asfaltohen rrugët kryesore në fshatrat Kotradiq dhe Turjakë, si dhe të rregullohen trotualet në rrugët kryesore të fshatrave.
4. Të vendoset sistemi i ujitjes së tokave bujqësore.
5. Të mblidhen mbeturinat nga Komuna.

Bashkësia Teritoriale Nabërgjan

Bashkësia Teritoriale Nabërgjan përfshin fshatin Nabërgjan dhe një pjesë të fshatit Nakëll. Numri i banorëve në këtë Bashkësi Teritoriale është 2 500 – 3 000.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të Bashkësisë Teritoriale Nabërgjan është mesatarisht e mirë. Rruga Nabërgjan-Zahaq është e asfaltuar dhe gjithashtu rruga në fshatin Nabërgjan është asfaltuar para disa vitesh, por megjithatë është shumë e ngushtë si dhe ka filluar të dëmtohet. Gjithashtu, rruga Pejë – Trestenik që lidhet me Klinën është në gjendje mjaft të keqe, kurse rrugët lokale të fshatrave nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia teritoriale ka një shkollë fillore në fshatin Nabërgjan, në të cilën vijnë mësimin 400 nxënës. Gjithashtu, në Nabërgjan do të ndërtohet edhe një shkollë fillore;
- ❖ Fshati Nakëll nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit, kurse në fshatin Nabërgjan vetëm disa shtëpi janë të lidhura me këtë rrjet. Megjithatë, banorët shprehen se ky projekt do të vazhdojë edhe në pjesën tjetër të fshatit si dhe në fshatin Nakëll;
- ❖ Fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale Nabërgjan nuk ka ambulancë. Për shërbime mjekësore banorët udhëtojnë nga 12 km., deri në Pejë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Nabërgjan

1. Të vazhdohet projekti për vendosjen e rrjetit të ujësjellësit.

2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
3. Të asfaltohet rruga në fshatrat Nabërgjan dhe Nakëll.
4. Të ndërtohet zyra e vendit.
5. Të ndërtohet një ambulancë.
6. Të investohet në rrjetin elektrik.
7. Të mblidhen mbeturinat.

Bashkësia Teritoriale Trestenik

Bashkësia Teritoriale Trestenik përfshin 3 fshatra: Trestenik, Arbanë dhe Ruhot. Numri i banorëve në këtë Bashkësi Teritoriale është mbi 3 000.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të Bashkësisë Teritoriale Trestenik është shumë e keqe. Asnjë nga rrugët e fshatrave nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia teritoriale ka dy shkolla fillore: një në fshatin Trestenik dhe tjetra në fshatin Arbanë. Që të dy shkollat i plotësojnë kushtet për zhvillimin e mësimin. Shkolla në Arbanë është ndërtuar kohët e fundit, kurse shkolla në Trestenik është renovuar;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e Bashkësisë Teritoriale Trestenik nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Banorët shprehen se projekti për vendosjen e rrjetit të ujësjellësit kishte filluar në disa fshatra të tjerë gjatë vitit të kaluar dhe ishte planifikuar të vazhdonte edhe në fshatrat e Bashkësisë Teritoriale të Trestenikut. Çështjen e mosvazhdimin të këtij projekti banorët e kanë paraqitur edhe në Komunë;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale Trestenik ka një ambulancë në fshatin Trestenik. Megjithatë, ka disa muaj që mjeku nuk punon në ambulancë. Këtë çështje banorët gjithashtu e kanë paraqitur në Komunë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Trestenik

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
3. Të asfaltohet rruga Trestenik – Pejë, rrugë kjo që e lidh edhe komunën e Pejës me atë të Klinës.
4. Të asfaltohet rrugët në të gjitha fshatrat.
5. Të investohet në rrjetin elektrik.
6. Të hapet Zyra e Vendi.
7. Të sigurohet lokacioni për varrezat e fshatit.
8. Të renovohet Shtëpia e Kulturës.
9. Të hapet një filialë e PTK-së.
10. Të mblidhen mbeturinat nga komuna.
11. Të furnizohet me banka dhe karrige shkolla e Trestenikut.

Bashkësia Teritoriale Dubovë-Ozdrim

Bashkësia Teritoriale Dubovë-Ozdrim përfshin fshatrat: Dubovë e madhe dhe Ozdrim. Numri i banorëve në këtë Bashkësi Teritoriale është rreth 3 000.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të Bashkësisë Teritoriale Dubovë-Ozdrim është mesatarisht e mirë. Veç një rruge kryesore e cila nuk është e asfaltuar, rrugët tjera kryesore janë të asfaltuara. Kurse, rrugët lokale të fshatrave nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia teritoriale ka një shkollë fillore, e cila pas tre vitesh ndërprerje ka rifilluar të renovohej;
- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit. Gjendja më e keqe është në fshatin Dubovë, ku një pjesë e banorëve i derdhin ujërat e zeza në lum, kurse pjesa tjetër në gropa septike;
- ❖ Bashkësia Teritoriale Dubovë-Ozdrim ka një ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Dubovë-Ozdrim

1. Të ndërtohet ura në Dubovë dhe të asfaltohet rruga.
2. Të ndërtohet mbikalimi në rrugën magjistrale Pejë-Mitrovicë. Mungesa e këtij mbikalimi rrezikon veç banorëve edhe nxënësit që shkojnë në shkollë nëpër këtë rrugë.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
4. Të ndërtohet një qendër sportive. Parcela për ndërtimin e kësaj qendre është në Dubovë.

Bashkësia Teritoriale Treboviq

Bashkësia Teritoriale Treboviq përfshin 5 fshatra: Treboviq, Katund i ri, Bllagajë, Pavlan dhe Qyshk.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të Bashkësisë Teritoriale Treboviq nuk është e mirë. Fshatrat Bllagaj dhe Pavlan nuk i kanë rrugët e asfaltuara, në fshatin Treboviq rreth 3 km. rrugë nuk janë të asfaltuara dhe gjithashtu rruga 800 m. në fshatin Katund i Ri nuk është e asfaltuar;

- ❖ Bashkësia teritoriale ka dy shkolla fillore: një shkollë fillore në fshatin Treboviq dhe tjetra në fshatin Qyshk. Gjithashtu, është duke u ndërtuar një paralele e ndarë në fshatin Katund i ri;
- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale ka një ambulancë në fshatin Treboviq;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Treboviq

1. Të asfaltohen rrugët në fshatrat: Bllagaj, Pavlan, Treboviq (rreth 3 km) dhe rruga në fshatin Katund i ri (800 m).
2. Të asfaltohet rruga Trestenik-Qendër. Kjo rrugë i lidh fshatrat e kësaj Bashkësie teritoriale.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshatra.
4. Të zgjidhet çështja pronësore e lokacionit të varrezave.

Bashkësia Teritoriale Vitomiricë

Bashkësia Teritoriale Vitomiricë përfshin Vitomiricën dhe 3 rajone: Vitomirica 1, 2 dhe 3. Numri i banorëve në këtë Bashkësi Teritoriale është 8 000 – 10 000.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të Bashkësisë Teritoriale Vitomiricë është mesatarisht e mire. Rreth 50 % të rrugëve janë të asfaltuara. Rruga kryesore për Rozhajë, rruga kryesore për Mitrovicë dhe gjithashtu tri rrugë kryesore janë të asfaltuara, kurse pesë rrugë të tjera kryesore nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia teritoriale ka një shkollë fillore, në të cilën vijnë mësimin rreth 1000 nxënës. Kushtet për vijimin e mësimit në shkollë janë 70 % të mira, pasi një pjesë e shkollës është e vjetër dhe ka nevojë për renovim;
- ❖ Bashkësia teritoriale është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë furnizimi me ujë sidomos gjatë stinës së verës nuk është i rregullt;
- ❖ Bashkësia teritoriale nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Bashkësia Teritoriale ka një ambulancë, megjithatë kushtet në këtë ambulancë nuk janë të mira;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Vitomiricë

1. Të rregullohet trotuari në rrugën kryesore për Mitrovicë. Mungesa e trotuarit rrezikon veç banorët edhe nxënësit.
2. Të rregullohet rrjeti i ujësjellësit dhe të përmirësohet furnizimi me ujë.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në tërë Bashkësinë teritoriale.
4. Të renovohet një pjesë e shkollës fillore, e cila është e vjetër.

5. Të ofrohen shërbime mjekësore në ambulancë gjatë 24 orëve.
6. Të investohet në rrjetin elektrik.

Bashkësia Teritoriale Poqestë

Bashkësia Teritoriale Poqestë përfshin 6 fshatra: Poqestë, Millovanc, Vragoc, Pishtan, Babiq dhe Krstovc. Një pjesë e banorëve të Bashkësisë teritoriale jetojnë jashtë vendit, kurse numri i banorëve të përhershëm është 1 300.


Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të Bashkësisë Teritoriale Poqestë nuk është e mirë. Rruga kryesore që i lidh fshatrat është mjaft e dëmtuar dhe gjithashtu rrugët lokale në fshatra nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Bashkësia teritoriale ka një shkollë fillore në fshatin Poqestë dhe një shkollë katër vjeçare në fshatin Babiq. Në këto shkolla vijnë mësimin 250 nxënës nga të gjitha fshatrat. Distanca më e largët për nxënësit e fshatrave tjerë deri në fshatin Poqestë është 6 km.;
- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit. Ujërat e zeza derdhen në gropa septike dhe gjendja në fshatra është shumë e keqe;
- ❖ Bashkësia Teritoriale ka një ambulancë në fshatin Poqestë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Bashkësisë Teritoriale Poqestë

1. Të asfaltohet rruga kryesore që i lidh fshatrat.
2. Të asfaltohet rruga që i lidh fshatrat Ramun dhe Poqestë.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
4. Të investohet në rrjetin elektrik, sepse është shumë i dobët.
5. Të bëhet sistemi i ujitjes së tokave bujqësore, sepse rreth 90% e banorëve merren me bujqësi.

KOMUNA E GJAKOVËS



Hatra e qytetit

Komuna e Gjakovës ka 586 km², të cilën e përbëjnë qyteti dhe 84 fshatra. Sipas regjistrimit të fundit i bërë në vitin 2000 nga UNMIK-u, komuna e Gjakovës ka 150.800 banorë, duke e renditur si komuna e tretë për nga madhësia në Kosovë.

Komuna e Gjakovës ka një pozitë shumë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën juglindore të Rrafshit të Dukagjinit, në pjesën jugperendimore të Kosovës, është pjesë përbërëse e regjionit qendror të Gadishullit Ballkanik dhe pjesës Juglindore të Evropës.

Komuna e Gjakovës kufizohet me Republikën e Shqipërisë me të cilën ka dy pika kufitare, atë të Qafës së Prushit në Jug - ku lidhet me Regjionin e Hasit (Letaj, Krum, Kukës, etj.) dhe atë të Qafës së Morinës në perendim - që lidhet Malësin e Gjakovës (Tropojë, Bajram Curr, etj.). Komuna e Gjakovës kufizohet edhe me Komunat si: Prizrenit, Rahovecit, Malishevës, Klinës, Pejës dhe Deçanit.

Komuna e Gjakovës është e përbërë prej këtyre vendbanimeve: Babaj Bokës; Bardhaniq; Batushë; Bec; Berjahë; Bardhasan; Bishtazhin; Bitesh; Brekoc; Brovinë; Cërmjan; Dallashaj; Damjan; Devë; Doblibarë; Dobrixhë; Dobrosh; Doll; Dujakë; Duzhnjë; Firajë; Firzë; Fshaj; Gërçinë; Gërgoc; Goden; Guskë; Gjakovë; Hereq; Jabllanicë; Jahoc; Janosh; Kodrali; Korenicë; Koshare; Kralan; Kusar; Kushavec; Lipovec; Llugagji; Lugbunar; Madanaj; Marmull; Mejë; Meqë; Moglicë; Nec; Netic; Nivokaz; Novosellë e Epërme; Novosellë e Ulët; Orize; Osek Hylë; Osek Pashë; Pacaj; Palabardhë; Pjetërshan; Plançor;

Ponoshec; Popoc; Piskotë; Qerim; Qerret; Raçë; Radoniq; Rakoc; Rakovinë; Molliq; Morinë; Ramoc; Rashkoc; Rogovë; Racaj; Rezinë; Rrypaj; Sheremet; Shishman; Skivjan; Smaq; Smolicë; Sopot; Stubëll; Trakaniq; Ujz; Vogovë; Vraniq; Zidi i Sadikagës; Zhabell; Zhdredhë; Zhub; Zylfaj.

PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS

Qyteti i Gjakovës

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e qytetit të Gjakovës është e mirë. Rrugët kryesore janë të asfaltuara, megjithatë disa rrugë në lagjet e reja nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Gjakova ka 6 shkolla fillore dhe 4 shkolla të mesme. Kushtet për zhvillimin e mësimin në shkolla janë të mira, veç gjimnazit i cili nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin, por i cili është duke u renovuar;
- ❖ Gjakova është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Gjithashtu, Gjakova është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Në Gjakovë është një Q.M.F.- Qendër e Mjekësisë Familjare;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna. Megjithatë, një pjesë e banorëve hudhin mbeturina në lumin Krena.

Rekomandimet e banorëve të Qytetit të Gjakovës

1. Të asfaltohen rrugët në lagjet e reja dhe të vendoset ndriqimi.
2. Të rregullohet rrjeti elektrik, i cili në disa lagje është shumë i vjetër.

Zyra e Gjendjes Civile Bec

Zyra e Gjendjes Civile Bec përfshin 8 fshatra: Bec, Zhdredhë, Janosh, Sopot, Lugbunar, Qerim, Doblibarë dhe Vraniq.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje është e mirë. Rrugët kryesore të fshatrave janë të asfaltuara, megjithatë ka rrugë lokale të fshatrave që nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Kjo Zyrë ka dy shkolla fillore; në fshatin Bec dhe fshatin Doblibarë si dhe 3 paralele të ndara në fshatrat Lugbunar, Zhdredhë dhe Vraniq.
- ❖ Të gjitha fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Zyrë ka dy ambulanca- një në fshatin Bec dhe tjetra në fshatin Doblibarë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Bec

1. Të rregullohet trotuari me gjatësi 5 km., prej fshatit Qerim deri në fshatin Bec, si dhe në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave. Në mungesë të trotuareve, banorët e këtyre fshatrave dhe sidomos nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
3. Të investohet në rrjetin elektrik, sepse është shumë i vjetër.
4. Të ndërtohet një Qendër rinore.



Qarshia e vjetër

Zyra e Gjendjes Civile Cërmjan

Zyra e Gjendjes Civile Cërmjan përfshin 6 fshatra: Cërmjan, Kodrali, Rashkoc, Netic, Meqe dhe Rakovinë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje nuk është e mirë. Veç rrugës kryesore që shkon për Jabllanicë, asnjë nga rrugët tjera në këto fshatra nuk është e asfaltuar;
- ❖ Kjo Zyrë ka një shkollë fillore dhe një shkollë të mesme në fshatin Cërmjan, si dhe 3 paralele të ndara në fshatrat: Cërmjan dhe Meqe. Veç shkollës fillore në Cërmjan gjendja e shkollave të tjera është e mirë. Shkolla fillore në Cërmjan ndonëse është renovuar pas vitit 1999, nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin dhe gjithashtu mungon rrethoja e shkollës;
- ❖ Të gjitha fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, veç një pjese të fshatit Cërmjan që nuk është i lidhur me këtë rrjet. Megjithatë, furnizimi me ujë në fshatrat Cërmjan, Rakoc dhe Kodrali nuk është i mjaftueshëm;
- ❖ Asnjë fshat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Zyrë ka një ambulancë në fshatin Cërmjan;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Cërmjan

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
2. Të përmirësohet furnizimi me ujë në fshatrat: Cërmjan, Rakoc dhe Kodrali.
3. Të asfaltohen rrugët dhe trotualet në fshatra.



Pallati i kulturës Gjakovë

Zyra e Gjendjes Civile Gërgoc

Zyra e Gjendjes Civile Gërgoc përfshin 7 fshatra: Gërgoc, Zhabel, Bardhaniq, Llugagji, Kralan, Jabllanicë dhe Rakoc.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje nuk është e mirë. Vetëm rruga regjionale Gjakovë-Pejë që kalon pranë fshatrave është e asfaltuar, kurse gjendja më e keqe është në fshatin Zhabel;
- ❖ Kjo Zyrë ka 5 shkolla fillore, në fshatrat Zhabel, Kralan, Jabllanicë dhe Gërgoc;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Banorët furnizohen me ujë përmes puseve individuale;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Zyrë ka tri ambulanca, të cilat ndodhen në fshatrat Kralan, Gërgoc dhe Jabllanicë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Gërgoc

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
3. Të asfaltohen rrugët e fshatrave. Veç fshatrave Kralan dhe Jabllanicë, rrugët në fshatrat tjerë nuk janë të asfaltuara.



Kryesuesja e Kuvendit të Gjakovës znj. Teuta Haxhiu dhe Drejtori i Administratës z. Mark Komoni gjatë takimit në Gjakovë

Zyra e Gjendjes Civile Skivjan

Zyra e Gjendjes Civile Skivjan përfshin 7 fshatra: Skivjan, Osek Hylë, Plançor, Hereq, Dujakë, Firajë dhe Dobrixhë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje është pjesërisht e mirë. Rruga regjionale Gjakovë-Pejë që kalon pranë fshatrave, rruga në fshatin Hereq, rruga në fshatin Dujakë si dhe një pjesë e rrugës në fshatin Osek Hylë janë të asfaltuara, kurse rrugët në fshatrat tjerë nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e Gjendjes Civile Skivjan ka 5 shkolla fillore të cilat ndodhen në fshatrat: Skivjan, Hereq, Dujakë, Dobrixhë dhe Osek Hylë. Kushtet për zhvillimin e mësimin në shkolla janë të mira, veç shkollës në Osek Hylë e cila është e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për mësim;
- ❖ Vetëm fshatrat Skivjan dhe Osek Hylë janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por megjithatë ka 9 muaj që ky rrjet nuk funksionon. Kurse, fshatrat Plançor, Hereq, Dujakë, Firajë dhe Dobrixhë nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo zyrë ka një ambulancë në fshatin Skivjan. Gjithashtu, në fshatin Dujakë ndodhet objekti i ambulancës por nuk funksionon;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Skivjan

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
2. Të përmirësohet furnizimi me ujë në fshatrat Skivjan dhe Osek Hylë si dhe të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshatrat Plançor, Hereq, Dujakë, Firajë dhe Dobrixhë.
3. Të ndërtohet një fushë sportive në fshatin Skivjan.
4. Të ndërtohet një Qendër Kulturore.



Takim me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe zyrtarët e Komunës së Gjakovës

Zyra e Gjendjes Civile Ponoshec

Zyra e Gjendjes Civile Ponoshec përfshin 10 fshatra: Ponoshec, Morinë, Popoc, Shishman, Babaj Bokës, Duzhnjë, Nec, Stubëll, Berjahë dhe Smolicë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje është kryesisht e mirë;
- ❖ Kjo zyrë ka 3 shkolla fillore në fshatrat: Ponoshec, Babaj Bokës dhe Smolicë dhe 2 shkolla katër vjeçare në fshatrat: Morinë dhe Nec;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo zyrë ka 2 ambulanca në fshatrat Ponoshec dhe Babaj Bokës;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Ponoshec

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.

Zyra e Gjendjes Civile Molliq

Zyra e Gjendjes Civile Molliq përfshin 5 fshatra: Molliq, Batushë, Koshare, Nivokaz dhe Brovinë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje është kryesisht e mirë;
- ❖ Kjo zyrë ka një shkollë fillore në fshatin Molliq. Kushtet për zhvillimin e mësimin në shkollë janë të mira;
- ❖ Vetëm fshatrat Molliq dhe Brovinë janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, kurse fshatrat Batushë, Koshare dhe Nivokaz nuk janë të lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Vetëm fshati Brovinë është i lidhur me rrjetin e kanalizimit, kurse fshatrat Molliq, Batushë, Koshare dhe Nivokaz nuk janë të lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Kjo zyrë ka një ambulancë në fshatin Molliq;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Molliq

1. Të ndërtohen trotualet në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave.
2. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshatrat: Batushë, Koshare dhe Nivokaz.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshatrat: Molliq, Batushë, Koshare dhe Nivokaz.

Zyra e Gjendjes Civile Brekoc

Zyra e Gjendjes Civile Brekoc përfshin 14 fshatra: Brekoc, Vogovë, Zhub, Zylfaj, Goden, Firzë, Raçë, Moglicë, Mejë, Jahoc, Korenicë, Devë, Orize dhe Guskë

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje është kryesisht e mirë. Shumica e rrugëve të fshatrave janë të asfaltuara;
- ❖ Kjo zyrë ka 7 shkolla fillore të cilat ndodhen në fshatrat: Brekoc, Mejë, Guskë, Korenicë, Goden dhe Vogovë;
- ❖ Fshatrat Jahoc, Mejë, Raçë, Moglicë dhe gjysma e fshatit Brekoc janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, kurse fshatrat Vogovë, Zhub, Zylfaj, Goden, Firzë, Korenicë, Devë dhe Guskë nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo zyrë ka tri ambulanca të cilat ndodhen në fshatrat: Brekoc, Guskë dhe Kamenicë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Brekoc

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
2. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshatrat: Vogovë, Zhub, Zylfaj, Goden, Firzë, Korenicë, Devë dhe Guskë.
3. Të ndërtohen trotualet në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave, pasi banorët e në veçanti nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet.
4. Të mblidhen mbeturinat nga Komuna.

Zyra e Gjendjes Civile Rracaj

Zyra e Gjendjes Civile Rracaj përfshin 8 fshatra: Rracaj, Pacaj, Sheremet, Dallashaj, Rrypaj, Madanaj, Ramoc dhe Dobrosh.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Rruga kryesore që i përshkon fshatrat e kësaj Zyreje është e asfaltuar;
- ❖ Kjo zyrë ka dy shkolla fillore të cilat ndodhen në fshatrat: Sheremet dhe Madanaj;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo zyrë ka një ambulancë e cila ndodhet në fshatin Sheremet;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Rracaj

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
3. Të ndërtohet trotuari në rrugën që i përshkon të gjitha fshatrat, sepse banorët e në veçanti nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet.
4. Të rregullohet rrjeti elektrik në fshatin Rracaj.

Zyra e Gjendjes Civile Damjan

Zyra e Gjendjes Civile Damjan përfshin 2 fshatra: Damjan dhe Gërquinë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave është mesatarisht e mirë. Rruga kryesore që i lidh të dy fshatrat është e asfaltuar, kurse 4 rrugë nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Kjo zyrë ka 4 shkolla fillore, 3 prej të cilave ndodhen në fshatin Damjan dhe një në fshatin Gërquinë;
- ❖ Fshatrat Damjan dhe Gërquinë janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë ky rrjet nuk mbikqyret;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo zyrë ka një ambulancë e cila ndodhet në fshatin Damjan;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Damjan

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të dy fshatrat.
2. Të ndërtohet trotuari në rrugën kryesore që i lidh të dy fshatrat.
3. Të renovohej Zyra e Vendit.

Zyra e Gjendjes Civile Rogovë

Zyra e Gjendjes Civile Rogovë përfshin vetëm fshatin Rogovë, në të cilin jetojnë rreth 7500 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatit Rogovë është e mirë. Rreth 60% e rrugëve janë të asfaltuara. Megjithatë, disa rrugë lokale të fshatit nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Fshati Rogovë ka dy shkolla: shkollën e mesme-Gjimnazi i përgjithshëm dhe shkollën fillore me rreth 1000 nxënës. Gjimnazi është ndërtuar kohët e fundit dhe kushtet për zhvillimin e mësimi janë të mira, kurse shkolla fillore është në renovim e sipër;
- ❖ Fshati është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ 80-90% e fshatit është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Fshati ka një Qendër të Mjekësisë Familjare-QMF. Kushtet për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në këtë qendër janë të mira, megjithatë ka nevojë që të shtohet numri i specialistëve;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna dhe mbeturinat hudhen kudo.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Rogovë

1. Në QMF të shtohet Reparti gjinekologjik, Laboratori për analiza të gjakut si dhe të shtohet numri i specialistëve. QMF në Rogovë ofron shërbime mjekësore edhe për banorët e fshatrave të Hasit.
2. Të vendoset ndriçimi publik. Vetëm 20% e fshatit ka ndriçim publik.
3. Të ndërtohet Zyra e gjendjes civile në Rogovë.

Zyra e Gjendjes Civile Novosellë e Epërme

Zyra e Gjendjes Civile Novosellë e Epërme përfshin 6 fshatra: Novosellë e epërme, Novosellë e poshtme, Trakaniq, Osek Pashë, Palabardhë dhe Bitesh.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave është kryesisht e mirë;
- ❖ Kjo zyrë ka dy shkolla fillore, të cilat ndodhen në fshatrat Novosellë epërme dhe Novosellë e poshtme;

- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por megjithatë furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo zyrë ka një ambulancë e cila ndodhet në fshatin Novosellë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Novosellë e Epërme

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
2. Të përmirësohet furnizimi me ujë.
3. Të ndërtohet trotuari në rrugën kryesore që i lidh fshatrat.

Zyra e Gjendjes Civile Bishtazhin

Zyra e Gjendjes Civile Bishtazhin përfshin 12 fshatra: Bishtazhin, Bardhasan, Marmull, Ujz, Fshaj, Smaq, Doll, Pjetërshan, Kusar, Lipovec dhe Kushavec, Rezinë.


Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave është kryesisht e mirë;
- ❖ Kjo zyrë ka tri shkolla fillore të cilat ndodhen në fshatrat Bishtazhin, Doll dhe Lipovec;
- ❖ Fshatrat Bishtazhin, Marmull, Bardhasan dhe Smaq janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, kurse fshatrat Ujz, Fshej, Doll, Pjetërshan, Kusar, Lipovec dhe Kushavec nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo zyrë ka tri ambulanca të cilat ndodhen në fshatrat Lipovec, Bishtazhin dhe Doll;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Gjendjes Civile Bishtazhin

1. Të ndërtohet trotuari në rrugën kryesore që i lidh fshatrat.
2. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshatrat: Ujz, Fshej, Doll, Pjetërshan, Kusar, Lipovec dhe Kushavec.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.

KOMUNA E DEÇANIT



Harta e qytetit

Qyteti i Deçanit është qendra e pjesës më perëndimore të Republikës së Kosovës, që gjendet buzë Bjeshkëve të Nemuna, që ngriten mbi lumin e Lumëbardhit të Deçanit. Komuna e Deçanit shtrihet në pjesën veriore të Dukagjinit. Në pjesën veri - perëndimore të Kosovës kufizohet me Pejën, në veri, veri - lindje dhe lindje me Gjakovën, në jug dhe jug - lindje gjendet Shqipëria dhe me Malin e Zi në perëndim dhe veri-perëndim.

Deçani ka një sipërfaqe prej 372 km², me numër të popullsisë mbi 66 000 banorë. Territori i komunës së Deçanit përfshinë këto vendbanime: Baballoq, Beleg, Belle, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ulët, Dashinoc, Deçan, Drenoc, Dubovik, Dubravë, Gllogjan, Gramaçel, Hulaj, Irzniq, Isniq, Kodrali, Lëbushë, Lumbardh, Lloqan, Llukë e Epërme, Llukë e Ulët, Maznik, Papiq, Pobërgjë, Pozhar, Prapaqan, Prekolluk, Prilep, Rastavicë, Ratish i Epërm, Ratish i Ulët, Sllup, Strelc i Epërm, Strelc i Ulët, Shaptej, Voksh, Vranoc i Vogël.

Në territorin e Komunës janë të themeluara këto Zyra të Vendit: I. Zyra qendrore në Deçan, II. Zyra e Vendit në Drenoc, III. Zyra e Vendit në Irzniq IV. Zyra e Vendit në Strelc dhe V. Zyra e Vendit në Isniq.

PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË DEÇANIT

Zyra e Vendit Deçan

Zyra e Vendit Deçan përfshin Deçanin dhe 4 fshatra: Carrabreg i ulët, Carrabreg i epërm, Llukë e epërme dhe Beleg.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Zyreje të vendit është e mirë. Rrugët kryesore dhe shumica e rrugëve lokale në Deçan janë të asfaltuara dhe gjithashtu rrugët në fshatrat Beleg, Carrabreg i epërm dhe Llukë e epërme janë të asfaltuara. Kurse, rruga në fshatin Carrabreg i ulët dhe disa rrugë lokale të fshatrave nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e Vendit ka një shkollë fillore dhe dy shkolla të mesme në Deçan si dhe një shkollë fillore në fshatin Llukë e epërme. Kushtet për zhvillimin e mësimin në këto shkolla janë të mira, megjithatë shkolla fillore në Deçan dhe shkolla e mesme profesionale nuk kanë sallë të edukatës fizike;
- ❖ Zyra e Vendit është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Veç fshatit Carrabreg i ulët në të cilin është duke u vendosur rrjeti i kanalizimit, Deçani dhe fshatrat tjerë nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Zyrë e vendit ka një Q.M.F – Qendër të mjekësisë familjare;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Deçan

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në Deçan dhe në fshatrat Carrabreg i epërm, Llukë e epërme dhe Beleg.
2. Të ndërtohet salla e edukatës fizike në shkollën fillore dhe atë të mesme profesionale në Deçan.
3. Të ndërtohet një çerdhe e fëmijëve në Deçan.
4. Të rregullohen hapsirat gjelbëruese.
5. Të investohet në rrjetin elektrik në Deçan dhe në fshatin Carrabreg i ulët. Rrjeti elektrik është i vjetër dhe i stërngarkuar.
6. Të kthehet në shërbim të qytetarëve pushimorja e fëmijëve dhe gjithashtu të lejohen ndërtimet në grykën e Deçanit.



Komuna e Deçanit

Zyra e Vendit Isniq

Zyra e Vendit Isniq përfshin 4 fshatra: Isniq, Prapaqan, Dubovik dhe Papriq.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Zyreje të vendit nuk është e mirë. Shumica e rrugëve kryesore janë të asfaltuara, megjithatë janë të vjetra dhe mjaft të dëmtuara. Në gjendje më të keqe është rruga Dubovik - Prapaqan – Isniq;
- ❖ Zyra e Vendit ka dy shkolla fillore, në fshatrat Isniq dhe Prapaqan dhe një shkollë pesë vjeçare në fshatin Dubovik. Megjithatë, shkolla në Isniq është e vjetër dhe ka nevojë të renovohet dhe gjithashtu shkolla në Dubovik nuk ka hapsirë të mjaftueshme. Nxënësit e fshatit Dubovik nga klasa e pestë udhëtojnë nga 3 km., për të vazhduar shkollimin në fshatin Prapaqan;
- ❖ Zyra e Vendit është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm. Gjithashtu, fshati Isniq ka probleme me furnizimin me ujë pasi gypat e ujësjellësit janë të vjetër. Megjithatë, banorët kanë marrë premtimin nga Komuna se në Isniq do të rregullohen gypat e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e Zyrës së Vendit Isniq nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit. Ujërat e zeza të fshatit Dubovik derdhen në lum dhe gjatë reshjeve lumi del nga shtrati dhe ka vërshime;
- ❖ Kjo Zyrë e vendit ka dy ambulanca, në fshatrat Isniq dhe Prapaqan;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Isniq

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
2. Të rregullohet furnizimi me ujë të pijshëm dhe gjithashtu të ndërrohen gypat e ujësjellësit në fshatin Isniq.
3. Të asfaltohet rruga Dubovik - Prapaqan – Isniq dhe të rregullohen trotuaret.
4. Të renovohet shkolla fillore në fshatin Isniq dhe gjithashtu të zgjerohet objekti i shkollës fillore në fshatin Dubovik, në mënyrë që nxënësit të vazhdojnë shkollimin deri në klasën e 9-të. Nxënësit e fshatit Dubovik vazhdojnë shkollimin në fshatin Prapaqan që ndodhet 3 km., larg nga fshati.

5. Të rregullohet sistemi i ujitjes së tokave bujqësore.
6. Të punoj mjeku kujdestar në ambulancë.
7. Të investohet në rrjetin elektrik në fshatra.
8. Të asfaltohen rrugët e lagjeve.



Kryetari i Komunës së Deçanit z. Rasim Selmanaj gjatë takimit në Deçan

Zyra e Vendit Drenoc

Zyra e Vendit Drenoc përfshin 7 fshatra: Drenoc, Voksh, Lloçan, Hulaj, Sllup, Prilep dhe Pobërgj.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Zyreje të vendit është mesatarisht e mirë. Shumica e rrugëve kryesore janë të asfaltuara, megjithatë rruga Drenoc - Prilep nuk është e asfaltuar dhe është në gjendje të keqe;
- ❖ Zyra e Vendit ka tri shkolla fillore, megjithatë shkolla në Drenoc është mjaft e vjetër dhe gjithashtu shkolla në fshatin Pobërgj nuk ka hapsirë të mjaftueshme dhe oborri i shkollës është shumë i vogël;
- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por furnizimi me ujë sidomos gjatë stinës së verës nuk është i mjaftueshëm;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e Zyrës së Vendit Drenoc nuk është janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Kjo Zyrë e vendit ka një ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Drenoc

1. Të asfaltohet rruga Drenoc – Prilep.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.

3. Të përmirësohet furnizimi me ujë të pijes në fshatra dhe të ndërrohen gypat e ujësjellësit në fshatin Voksh .
4. Të rregullohen trotuaret e rrugëve.
5. Të mblidhen mbeturinat.



Takim me përfaqësuesit e Shoqërisë civile dhe zyrtarët e Komunës së Deçanit

Zyra e Vendit Strelc

Zyra e Vendit Strelc përfshin 4 fshatra: Strelc i epërm, Strelc i ulët, Lëbushë dhe Belle.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Zyreje të vendit është mesatarisht e mirë. Rrugët kryesore janë të asfaltuara, veç rrugës kryesore 2 km., në fshatin Strelc i epërm dhe disa rrugë lokale në fshatra që nuk janë të asfaltuara. Banorët kanë marrë premtimin nga Komuna se rruga në fshatin Strelc i epërm do të asfaltohet;
- ❖ Zyra e Vendit ka dy shkolla fillore, në fshatrat Strelc i epërm dhe Lëbushë dhe një shkollë 4 vjeçare në fshatin Lëbushë;
- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm. Gjithashtu, në fshatin Strelc i epërm ky rrjet është i vjetër dhe gypat e ujësjellësit janë dëmtuar;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e Zyrës së Vendit Strelc nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit. Ujërat e zeza derdhen në gropa septike;
- ❖ Kjo Zyrë e vendit ka një ambulancë, në fshatin Strelc i epërm;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen pjesërisht nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Strelc

1. Të asfaltohet rruga në fshatin Strelc i epërm.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.

3. Të përmirësohet furnizimi me ujë të pijes.
4. Të zgjerohet objekti i QMF – Qendrës së mjekësisë familjare.
5. Të rregullohet sistemi i ujitjes së tokave bujqësore.



Takim me përfaqësuesit e Shoqërisë civile dhe zyrtarët e Komunës së Deçanit

Zyra e Vendit Irzniq

Zyra e Vendit Irzniq përfshin 17 fshatra: Irzniq, Kodrali, Pozhar, Llukë e Ulët, Lumbardh, Dashinoc, Vranoc i Vogël, Maznik, Ratishë e Ulët, Ratishë e Epërme, Glllogjan, Shaptej, Dubravë, Gramoçel, Baballoq, Rastavicë dhe Prekolluk.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e kësaj Zyreje të vendit është e mirë. Rrugët kryesore janë kryesisht të asfaltuara, veç rrugës në Maznik dhe rrugëve lokale në fshatra të cilat janë të paasfaltuara;
- ❖ Zyra e Vendit ka disa shkolla fillore. Megjithatë, shkollat në fshatrat Rastavicë dhe Glllogjan janë të vjetra dhe nuk i plotësojnë kushtet për zhvillimin e mësimi. Gjithashtu, oborri i shkollës në fshatin Baballoq nuk është i rregulluar dhe nuk ka fushë sportive;
- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm. Gjithashtu, në fshatrat Rastavicë, Baballoq ndonëse është punuar në rrjetin e ujësjellësit banorët nuk janë të kënaqur me cilësinë e punimeve dhe gypat e ujësjellësit janë vendosur vetëm pjesërisht;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e Zyrës së Vendit nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit, veç fshatit Rastavicë ku banorët deri diku e kanë zgjidhur vetë këtë çështje;
- ❖ Kjo Zyrë e vendit ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen pjesërisht nga komuna, kurse një pjesë e mbeturinave hudhen në lum.


Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Irzniq

1. Të asfaltohet rruga në fshatin Maznik.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.

Regjioni i Pejës: Pejë, Gjakovë, Deçan, Istog, Klinë, Junik
Kërkesat dhe rekomandimet e qytetarëve

3. Të përmirësohet furnizimi me ujë të pijes në fshatra dhe të përfundohet rrjeti i ujësjellësit në fshatin Rastavicë.
4. Të renovohet shkolla në fshatin Rastavicë dhe ajo në Glllogjan. Gjithashtu, të rregullohet oborri i shkollës dhe fusha sportive në fshatin Baballoq.
5. Të investohet në rrjetin elektrik në fshatra.
6. Të rregullohet sistemi i ujitjes së tokave bujqësore.

KOMUNA E ISTOGUT



Harta e qytetit

Istogu është një qytet i qetë afër bjeshkëve të Moknës me lartësi mbidetare gjer në 2 155 m. Istogu njihet me burime të ujit dhe rritje të peshqve dhe lidhet me rrugët kryesore në disa drejtime: Pejë, Mitrovicë, Prishtinë. Istogu shtrihet në pjesën veri – perëndimore të Kosovës dhe në pjesën veriore të Dukagjinit. Istogu ka sipërfaqe prej 453.84 km². Kufizohet në lindje me Komunën e Skënderajt, në jug me Komunën e Klinës, në jug – perëndim dhe perëndim me Komunën e Pejës, në veri me Malin e Zi dhe Serbinë si dhe në veri – lindje kufizohet me Komunën e Zubin Potokut.

Sipas regjistrimit të vitit 1981, Istogu kishte 50.011 banorë. Duke u mbështetur në shkallën vjetore të shtimit të popullsisë 2.2% në vit, Komuna e Istogut vlerësohet të ketë 64.342 banorë.

Fshatrat e Komunës së Istogut janë: Banjë, Banjicë, Belicë, Bellopojë, Carallukë, Cërrkolez, Cerrcë, Dobrushë, Dragolec, Drejë, Dubovë e Vogël, Dubravë, Gjurakoc, Istog, Istog i Poshtëm, Kalican, Kashicë, Kërrninë, Kosh, Kovragë, Lluga, Llukac i Begut, Llukac i Thatë, Lubovë, Lubozhdë, Mojstir, Muzhevinë, Orrobërdë, Osojan, Polanë, Prekallë, Prigodë, Rakosh, Serbobran, Shalinovicë, Shushicë, Sinajë, Staradran, Studenicë, Suhogërlle, Tomoc, Trubuhoc, Tuçep, Uçë, Veriq, Veriq i Ri, Vrellë, Zabllaq, Zallq dhe Zhakovë. Vendbanimet urbane të Komunës së Istogut janë: 1. Istogu, 2. Banja, 3. Gjurakoci, 4. Vrella dhe 5. Rakoshi.

PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË ISTOGUT

Zyra e Vendit Istog

Zyra e Vendit Istog përfshin Istogun dhe 10 fshatra: Cerrcë, Lubozhdë, Muzhevinë, Istog i poshtëm, Dubravë, Dragolec, Sinajë, Mojtir, Bellopojë dhe Llugë, në të cilat jetojnë rreth 25 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e Zyrës së Vendit Istog është e mirë. Rreth 90% e rrugëve kryesore të Istogut dhe të fshatrave janë të asfaltuara. Megjithatë, ka rrugë lokale të cilat nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e vendit ka një shkollë fillore dhe një shkollë të mesme në Istog dhe gjithashtu në oborrin e shkollës fillore është duke u ndërtuar edhe një shkollë fillore. Gjithashtu, në fshatrat Cerrcë, Muzhevinë dhe Dubravë ka shkolla katër vjeçare;
- ❖ Istogu dhe të gjitha fshatrat janë lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Istogu është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Zyra e Vendit Istog ka një QMF – Qendër të mjekësisë familjare në Istog dhe gjithashtu një ambulancë në fshatin Dubavë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Istog

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshatra.
2. Të rregullohen trotualet në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave.
3. Të vendoset ndriqimi në të gjitha fshatrat.

Zyra e Vendit Banjë

Zyra e vendit Banjë përfshin 7 fshatra: Banjë, Lubovë, Orrobërdë, Banjicë, Kashicë, Carrallukë dhe Dubovë e vogël. Në këto fshatra jetojnë 8-9 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje është e mirë. Rrugët kryesore të fshatrave janë të asfaltuara, veç fshatit Dubovë e vogël ku rruga kryesore nuk është e asfaltuar. Gjithashtu, veç rrugës kryesore të fshatit Banjë asnjë nga rrugët e fshatrave nuk kanë trotuar;
- ❖ Zyra e Vendit Banjë ka një shkollë fillore në fshatin Banjë dhe një shkollë të ciklit të ulët në Krashicë, në të cilën vijnë mësimin 800-900 nxënës. Megjithatë, shkolla në Banjë është ndërtuar para vitit 1999 dhe ndonëse është renovuar pjesërisht, kushtet për zhvillimin e mësimin në këtë shkollë nuk janë të mira.

Gjithashtu, nxënësit e fshatit Krashicë nga klasa e pestë dhe nxënësit e fshatit Dubovë udhëtojnë çdo ditë nga 3-5 km për të vijuar mësimin në fshatin Banjë;

- ❖ Të gjitha fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, veç fshatit Oroberdë i cili është pjesërisht i lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Veç fshatrave Banjë dhe Banjicë të cilët janë pjesërisht të lidhur me rrjetin e kanalizimit, asnjë nga fshatrat tjerë të kësaj zyreje nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Zyra e Vendit Banjë ka një ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna në fshatin Banjë dhe pjesërisht në fshatrat tjerë, ku banorët paguajnë për këtë shërbim.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Banjë

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
2. Të renovohej shkolla fillore në Banjë.
3. Të rregullohen trotualet në rrugët kryesore të të gjitha fshatrave.
4. Të vendoset ndriqimi në të gjitha fshatrat.



Zyra e Vendit Vrellë

Zyra e Vendit Vrellë përfshin 4 fshatra: Vrellë, Studenicë, Kaliqan dhe Prigodë, në të cilat jetojnë rreth 10 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje është e mirë. Rrugët kryesore të fshatrave janë të asfaltuara, megjithatë ka rrugë lokale të fshatrave të cilat nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e vendit ka dy shkolla fillore në fshatrat Vrellë dhe Kaliqan dhe gjithashtu një shkollë 4 vjeçare në fshatin Prigodë, në kuadër të shkollës së Vrellës;

- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, veç fshatit Kaliqan i cili është pjesërisht i lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Fshatrat Kaliqan dhe Prigodë nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit, kurse fshatrat Vrellë dhe Studenicë ndonëse janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit ky rrjet nuk funksionon. Investimi në rrjetin e kanalizimit në këto dy fshatra ishte bërë vitin e kalur nga Komuna;
- ❖ Zyra e Vendit Vrellë ka një ambulancë në fshatin Vrellë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Vrellë

1. Të rregullohen trotuaret në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave. Mungesa e trotuareve rrezikon veç banorëve edhe nxënësit, sepse shkolla në fshatin Vrellë dhe ajo në Kaliqan ndodhen pranë rrugës kryesore;
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshatrat Kaliqan dhe Prigodë, si dhe të përfundohet rrjeti i kanalizimit në fshatrat Vrellë dhe Studenicë.
3. Të vendoset ndriqimi në fshatra.



Nënkryetari i Komunës së Istogut z. Agron Demukaj gjatë takimit në Istog

Zyra e Vendit Dobrushë

Zyra e Vendit Dobrushë përfshin 5 fshatra: Dobrushë, Staradran, Trubuhoc, Prekallë dhe Llukac i begut, në të cilat jetojnë rreth 8 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje është mesatarisht e mirë. Veç rrugës Dobrushë-Prekallë që nuk është e asfaltuar, rrugët kryesore të fshatrave

janë të asfaltuara. Megjithatë, ka rrugë lokale të fshatrave të cilat nuk janë të asfaltuara;

- ❖ Zyra e Vendit ka tri shkolla fillore në fshatrat Staradan, Llukac i begut dhe Trubuhoc si dhe një shkollë katër vjeçare në fshatin Dobrushë. Shkolla fillore në Staradan dhe ajo në Trubuhoc janë ndërtuar kohët e fundit dhe i plotësojnë kushtet për zhvillimin e mësimin. Shkolla fillore në fshatin Llukac i begut ka 300 nxënës dhe kushtet për zhvillimin e mësimin në shkollë janë mesatarisht të mira. Kurse, shkolla katër vjeçare në Dobrushë është e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin. Në këtë shkollë vijnë mësimin rreth 130 nxënës;
- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Rrjeti i ujësjellësit në fshatra është bërë kohët e fundit nga Komuna;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Zyra e Vendit ka dy ambulanca në fshatrat Staradran dhe Dobrushë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Dobrushë

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
2. Të ndërtohen trotualet në rrugët kryesore. Mungesa e trotuareve rrezikon veç banorëve edhe nxënësit.



Takim me përfaqësuesit e Shoqërisë civile dhe zyrtarët e Komunës së Istogut

Zyra e Vendit Gjurakoc

Zyra e vendit Gjurakoc përfshin 11 fshatra: Gjurakoc, Tomoc, Kovragë, Veriq, Serbobran, Osojan, Zallq, Kosh, Drejë, Shalinovicë dhe Llukac i thatë. Në këto fshatra jetojnë mbi 10 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje është mesatarisht e mirë. Veç rrugës Tomoc-Llukac dhe Tomoc-Kovragë, rrugët kryesore të fshatrave janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e Vendit ka tri shkolla fillore, një shkollë pesë vjeçare dhe një shkollë të mesme teknike në Gjurakoc. Shkollat fillore ndodhen në fshatrat: Gjurakoc, Zallq dhe Serbobran, kurse shkolla 5 vjeçare në fshatin Veriq. Megjithatë, nxënësit e fshatit Veriq pas përfundimit të klasës së pestë vijnë në mësimin në shkollën në fshatin Rakosh, i cili ndodhet 5-6 km larg fshatit Veriq.
- ❖ Rreth 90% e fshatrave janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, kurse fshati Kovragë është pjesërisht i lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Veç fshatit Gjurakoc i cili është i lidhur me rrjetin e kanalizimit dhe pjesërisht fshati Tomoc, asnjë nga fshatrat tjerë nuk janë të lidhur me këtë rrjet;
- ❖ Zyra e Vendit Gjurakoc ka dy ambulanca, në fshatrat Gjurakoc dhe Zallq;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Gjurakoc

1. Të rregullohen trotualet në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit. Vetëm fshati Gjurakoc dhe pjesërisht fshati Tomoc janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit.
3. Të vendoset ndriqimi në fshatra.
4. Të sigurohet transporti për nxënësit e fshatit Veriq, të cilët pas përfundimit të klasës së pestë vijnë në mësimin në shkollën e fshatit Rakosh që ndodhet 5-6 km.



Takim me përfaqësuesit e Shoqërisë civile dhe zyrtarët e Komunës së Istogut

Zyra e vendit Rakosh

Zyra e Vendit Rakosh përfshin 8 fshatra: Rakosh, Shushicë, Zhakovë, Uçë, Cërkolez, Suhogërlle, Kërninë dhe Belicë. Në këto fshatra jetojnë rreth 10 000 banorë.


Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj Zyreje nuk është e mirë. Veç rrugës magjistrale Mitrovicë-Pejë, është e asfaltuar edhe rruga Rakosh-Uçë dhe gjithashtu është duke u asfaltuar rruga që i lidh fshatrat Uçë - Zhakovë - Shushicë - Dubravë. Ndërkaq, të pasasfaltuara janë rrugët: a) Rakosh - Kërninë – Belicë, b) Kërninë – Suhogërlle, c) Suhogërlle – Cërkolez dhe d) Cërkolez – Uçë;
- ❖ Zyra e Vendit ka tri shkolla fillore të cilat ndodhen në fshatrat: Rakosh, Shushicë dhe Uçë si dhe dy shkolla 5 vjeçare të cilat ndodhen në fshatrat Cërkolez dhe Kërninë. Megjithatë, shkolla në Rakosh dhe ajo në Uçë nuk i plotësojnë kushtet për zhvillimin e mësimi;
- ❖ Fshatrat Shushicë, Zhakovë dhe Rakosh janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por megjithatë furnizimi me ujë sidomos gjatë stinës së verës nuk është i mjaftueshëm. Kurse, fshatrat tjerë që nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit furnizohen me ujë përmes puseve por uji nuk është i pijshëm;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e kësaj zyreje nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit. Ujërat e zeza derdhen në ambient të hapur dhe paraqesin rrezik për banorët;
- ❖ Zyra e Vendit ka tri ambulanca, të cilat ndodhen në fshatrat: Rakosh, Shushicë dhe Cërkolez. Kurse, banorët e fshatrave të tjerë për shërbime mjekësore udhëtojnë nga 3-5 km.;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna. Mbeturinat hudhen kudo.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendi Rakosh

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
2. Të ndërrohen shtyllat elektrike në të gjitha fshatrat, sepse janë shumë të vjetra.
3. Të asfaltohen rrugët: a) Rakosh - Kërninë, b) Suhogërlle – Cërkolez – Rakosh, c) Zhakovë – Rakosh d) Cërkolez – Ujë dhe e) Shushicë – Rakosh. Gjithashtu, të rregullohen edhe trotualet, sepse nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet.
4. Të rregullohet rrjeti i ujësjellësit në fshatrat: Cërkolez, Suhogërlle, Kërninë dhe Belicë.

KOMUNA E KLINËS



Harta e qytetit

Komuna e Klinës përfshin një hapësirë prej 308.8 km². Aktualisht Klina llogaritet të ketë mbi 60 000 mijë banorë.

Komuna e Klinës është e përbërë prej fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Fshatrat e Komunës së Klinës janë: Berkovë, Binxhë, Bokshiq, Budisalc, Çabiq, Caravik, Deiq, Dobërdol, Dollc, Dollovë, Dranashiq, Drenoc, Dresnik, Dugajevë, Dush, Dush i Vogël, Gjurgjevik i Madh, Gjurgjevik i Vogël, Gllarevë, Grabanicë, Grabc, Gremnik, Jagodë, Jashanicë, Jelloc, Kërrnicë, Klinafc, Klinë, Këpuz, Krushevë e Madhe, Krushevë e Vogël, Leskoc, Nagllavë, Përçevë, Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Poshtëm, Pograxhë, Qeskovë, Qupevë, Radulloc, Ranoc, Resnik, Rixhevë, Rudicë, Sferkë, Shtupel, Siqevë, Stupë, Ujmirë, Videjë, Volljakë, Zabërgjë, Zajm, Zllakuqan, kurse lagjet urbane të Komunës së Klinës janë: 1.Qendra e qytetit; 2.Arbëria (ish-Perlina); 3.Dukagjini dhe 4.Tikveshi.

PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË KLINËS

Zyra e Vendit Klinë

Zyra e Vendit Klinë përfshin qytetin e Klinës dhe 10 fshatra: Dollc, Dresnik, Gremnik, Zajm, Videjë, Deiq, Krushevë e vogël, Gjurgjevik i vogël, Klinafc dhe Jagodë, në të cilën jetojnë mbi 20 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në Zyrën e Vendit Klinë është mesatarisht e mirë. Rrugët kryesore në qytet dhe në fshatra janë të asfaltuara, kurse rrugët lokale nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e Vendit ka dy shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme;
- ❖ Qyteti i Klinës dhe fshatrat Krushevë, Gjurgjevik i vogël dhe Klinafc janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por megjithatë uji nuk është i pijshëm dhe gjithashtu, gjatë stinës së verës furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm. Kurse, fshatrat Zajm, Jagodë dhe Deiq nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Vetëm qyteti i Klinës dhe fshati Gremnik janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Klina ka një QMF – Qendër të Mjekësisë familjare dhe gjithashtu fshati Jagodë ka një ambulancë. Fshatrat tjerë të kësaj zyreje për shërbime mjekësore udhëtojnë nga 3-5 km deri në Klinë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave bëhen vetëm në fshatin Gremnik dhe pjesërisht në Klinë.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Klinë

1. Të rregullohet çështja e ujit të pijshëm në Klinë dhe në fshatrat tjerë të kësaj zyreje.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit. Veç Klinës dhe fshatit Gremnik asnjë fshat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit.
3. Të asfaltohen rrugët lokale në Klinë dhe në fshatra.
4. Të vendoset ndriqimi në rrugët lokale në të gjitha fshatrat e kësaj zyreje.
5. Të ndërtohet një çerdhe e fëmijëve në Klinë.

Zyra e Vendit Budisalc

Zyra e Vendit Budisalc përfshin 5 fshatra: Budisalc, Rudicë, Krushevë e madhe, Stupë dhe Nagllavë, në të cilat jetojnë rreth 3 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj zyreje të vendit është mesatarisht e mirë. Disa nga rrugët kryesore në fshatra janë të asfaltuara, kurse shumica e rrugëve lokale nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e Vendit ka një shkollë fillore në fshatin Budisalc. Kushtet për zhvillimin e mësimin në këtë shkollë janë të mira, kurse largësia me e madhe për nxënësit e fshatrave të tjerë për në shkollë është 3 km;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e kësaj zyreje të vendit nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Asnjë nga fshatrat gjithashtu nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Zyra e Vendit ka një ambulancë në fshatin Budisalc;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Budisalc

1. Të asfaltohet rruga Zllakuqan-Budisalc-Trestenik.
2. Të rregullohet ura në fshatin Zllakuqan dhe ajo në Rudicë. Këto ura nuk kanë mbrojtëse dhe paraqesin rrezik për banorët dhe në veçanti për nxënësit.
3. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat e kësaj zyreje.
4. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
5. Të mblidhen mbeturinat nga komuna.
6. Të rregullohet rrjeti elektrik, sepse është shumë i vjetër.

Zyra e Vendit Zllakuqan

Bashkësia lokale Zllakuqan përfshin 5 fshatra: Zllakuqan, Ranoc, Leskoc, Radulloc dhe Bërkovë, në të cilat fshatra jetojnë rreth 4 500 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në fshatrat e kësaj zyreje të vendit është mesatarisht e mirë. Megjithatë, në gjendje më të keqe janë rrugët Ranoc – Leskoc dhe Zllakuqan – Ranoc që lidhet me Shtupel;
- ❖ Zyra e Vendit ka një shkollë fillore në fshatin Zllakuqan si dhe një paralele të ndarë në fshatin Leskoc. Shkolla në Leskoc është ndërtuar vitet e fundit, kurse shkolla në Zllakuqan është e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin;
- ❖ Zyra e Vendit nuk është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Vetëm në fshatin Bërkovë banorët deri diku e kanë zgjidhur vetë këtë çështje;
- ❖ Zyra e Vendit Zllakuqan nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit. Gjendja më e keqe është në fshatin Zllakuqan ku ujërat e zeza derdhen në lum;
- ❖ Zyra e Vendit ka një ambulancë në fshatin Zllakuqan;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Zllakuqan

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat e kësaj zyreje.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
3. Të asfaltohen rrugët: Ranoc – Leskoc dhe Zllakuqan – Ranoc që lidhet me Shtupel.
4. Të renovohet shkolla fillore.



Pamje e qytetit

Zyra e vendit Drenoc

Zyra e Vendit Drenoc përfshin 9 fshatra: Drenoc, Grabanicë, Dubajevë, Pjetërq i poshtëm, Pjetërq i epërm, Bokshiq, Dollovë, Këpuz dhe Qeskovë, në të cilat fshatra jetojnë 5000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatrave të kësaj zyreje të vendit është e mirë;
- ❖ Zyra e Vendit ka tri shkolla, në fshatrat: Drenoc, Pjetërq dhe Grabanicë si dhe një paralele të ndarë në fshatin Këpuz. Megjithatë, sidomos shkolla në fshatin Këpuz nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimi. Numri i nxënësve që vijnë në mësimin në këto shkolla është rreth 700 nxënës;
- ❖ Fshatrat Grabanicë, Qeskovë dhe Këpuz janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por uji nuk është i pijshëm dhe sidomos gjatë stinës së verës furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm. Kurse, fshatrat tjerë të kësaj zyreje nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Veç fshatit Drenoc asnjë nga fshatrat tjerë të kësaj zyreje nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Zyra e Vendit Drenoc ka dy ambulanca, të cilat ndodhen në fshatrat Drenoc dhe Grabanicë. Banorët e fshatrave të tjerë udhëtojnë nga 3-5 km;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Drenoc

1. Të rregullohet çështja e ujit të pijes. Banorët janë të rrezikuar, pasi uji i pijes ndotet nga ujërat e zeza;
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit. Veç fshatit Drenoc asnjë nga fshatrat tjerë nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit.
3. Të rregullohet rrjeti elektrik. Shtyllat elektrike janë vendosur në vitet e 70-ta.

Zyra e Vendit Jashanicë

Zyra e Vendit Jashanicë përfshin 6 fshatra: Jashanicë, Pograxhë, Resnik, Jelloc, Dush dhe Gjurgjevik i madh, në të cilat jetojnë rreth 7 500 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në fshatrat e kësaj zyreje të vendit është e mirë. Rrugët kryesore në të gjitha fshatrat janë të asfaltuara. Megjithatë, ka rrugë lokale të cilat nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e Vendit ka dy shkolla fillore në fshatin Jashanicë dhe dy paralele të ndara në fshatrat Gjurgjevik dhe Resnik. Ndonëse shkollat tjera i plotësojnë kushtet për zhvillimin e mësimin, shkolla në Jashanicë është ndërtuar në vitin 1946 dhe megjithqë është renovuar disa herë kjo shkollë nuk është në gjendje të mirë;
- ❖ Vetëm fshatrat Resnik dhe Gjurgjevik i madh nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Veç fshatit Dushk, asnjë nga fshatrat tjerë nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Zyra e Vendit Jashanicë ka dy ambulanca në fshatin Jashanicë. Largësia e banorëve të fshatrave të tjerë për të marrë shërbime mjekësore në këtë ambulancë është 3-6 km;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Jashanicë

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshatrat Resnik dhe Gjurgjevik i madh.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit. Vetëm fshati Dushk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit.
3. Të rregullohet rrjeti elektrik, sepse është shumë i vjetër.
4. Të rregullohen trotualet në rrugët Dushk-Jashanicë dhe Pograxhë-Jashanicë. Mungesa e trotuareve paraqet rrezik nga automjetet jo vetëm për banorët por edhe për nxënësit.
5. Të rregullohet çështja pronësore e lokacionit të pikës së grumbullimit të qumështit. Afër zyrës së vendit ka qenë pika e grumbullimit të qumështit, e cila tani është uzurpuar.
6. Të mblidhen mbeturinat nga komuna.



Takim me përfaqësuesit e Shoqërisë civile dhe zyrtarët e Komunës së Klinës

Zyra e Vendit Ujmirë

Zyra e vendit Ujmirë përfshin 4 fshatra: Ujmirë, Çabiq, Siqevë dhe Dobërdol, në të cilat jetojnë rreth 6 500 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në fshatrat e kësaj zyreje të vendit është mesatarisht e mirë. Vetëm në fshatrat Çabiq dhe Ujmirë rrugët kryesore janë të asfaltuara. Kurse, rrugët lokale në asnjë fshat nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e Vendit ka një shkollë fillore në fshatin Ujmirë dhe një paralele të ndarë në fshatin Çabiq. Në këto shkolla vijojnë mësimin rreth 700 nxënës dhe kushtet për zhvillimin e mësimin në shkolla janë të mira;
- ❖ Vetëm fshatrat Ujmirë dhe Siqevë janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, kurse fshatrat Çabiq dhe Dobërdol nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Veç fshatit Çabiq asnjë nga fshatrat tjerë nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Zyra e Vendit ka një ambulancë në fshatin Ujmirë. Largësia e banorëve të fshatrave të tjerë për të marrë shërbime mjekësore në këtë ambulancë është 1-2 km.;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Ujmirë

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshatrat Çabiq dhe Dobërdol.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit. Vetëm fshati Çabiq është i lidhur me rrjetin e kanalizimit.
3. Të rregullohen trotualet në rrugët: a) Çabiq deri te shkolla b) Dobërdol-Ujmirë dhe Siqevë-Ujmirë. Mungesa e trotuareve paraqet rrezik nga automjetet jo vetëm për banorët por edhe për nxënësit të cilët shkojnë në shkollë përgjatë rrugës.
4. Të asfaltohet rruga Çabiq – Ujmirë.

5. Të ndërtohet një ambulancë në fshatin Çabiq.
6. Të përmirësohet rrjeti elektrik, sepse është shumë i dobët.
7. Të mblidhen mbeturinat nga Komuna.

Zyra e Vendit Gllarevë

Zyra e Vendit Gllarevë përfshin 4 fshatra: Gllarevë, Rixhevë, Carravik dhe Zabërgjë, në të cilat jetojnë rreth 6 000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në fshatrat e kësaj zyreje të vendit është e mirë. Rrugët kryesore të fshatrave janë të asfaltuara;
- ❖ Zyra e Vendit ka dy shkolla në fshatrat Gllarevë dhe Carravik, në të cilat vijojnë mësimin rreth 1000 nxënës. Kushtet për zhvillimin e mësimin në shkolla janë të mira;
- ❖ Asnjë nga fshatrat e kësaj zyreje të vendit nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Banorët furnizohen me ujë përmes puseve, por uji në këto puse është i ndotur;
- ❖ Të gjitha fshatrat janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit. Rrjeti i kanalizimit në fshatra është vendosur këtë vit nga Komuna dhe me bashkëfinancim nga qytetarët;
- ❖ Zyra e Vendit Gllarevë ka dy ambulanca, në fshatrat Gllarevë dhe Carravik;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vendit Gllarevë

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit. Asnjë nga fshatrat e kësaj zyreje të vendit nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit.
2. Të rregullohet trotuari në rrugën magjistrale Pejë - Prishtinë. Mungesa e trotuarit paraqet rrezik jo vetëm për banorët por edhe për nxënësit e fshatrave Rixhevë dhe Gllarevë të cilët shkojnë në shkollë përgjatë kësaj rruge.
3. Të mblidhen mbeturinat nga Komuna.
4. Të rregullohet rrjeti elektrik, në të gjitha fshatrat. Trafot elektrike janë shumë të vjetra.

Zyra e Vendit Sfërkë

Zyra e Vendit Sfërkë përfshin 5 fshatra: Sfërkë, Dush, Voljakë, Qypevë dhe Përqevë, në të cilat jetojnë mbi 8 000 banorë. Kërkesë e përbashkët për banorët e të gjitha fshatrave të Zyrës së Vendit Sfërkë është që të ndërrohen shtyllat elektrike në të gjitha fshatrat.

Fshati Sfërkë

Fshati Sfërkë ka rreth 3000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në fshatin Sfërkë është e mirë. Rruga kryesore është e asfaltuar, megjithatë ka rrugë lokale që janë të paasfaltuara dhe gjithashtu nuk është e asfaltuar rruga Sfërkë-Përqevë që i lidh fshatrat;
- ❖ Fshati ka një shkollë fillore. Megjithatë, shkolla është e vjetër dhe kushtet për zhvillimin e mësimin në shkollë nuk janë të mira dhe ndonëse është shtuar një aneks hapsira në shkollë nuk është e mjaftueshme. Në këtë shkollë vijnë mësimin 800 nxënës;
- ❖ Fshati është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm;
- ❖ Fshati Sfërkë nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Fshati ka një ambulancë, por ambulanca nuk punon rregullisht dhe gjithashtu ka mungesë të barërave;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna. Mbeturinat hudhen kudo.

Rekomandimet e banorëve të fshatit Sfërkë

1. Të investohet në rrjetin e ujësjellësit.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit
3. Të respektohet orari i punës në ambulancë.
4. Të ndërtohet një çerdhe e fëmijëve. Në fshat është parcela për ndërtimin e çerdhes.
5. Të ndërtohet rruga Sfërkë-Përqevë.
6. Të ndërtohet trotuari në aksin rrugor për Gjakovë.
7. Të ndërtohet një postë.
8. Të ndërtohet zyra e vendit.
9. Të mblidhen mbeturinat.
10. Të vendoset ndriqimi në fshat.
11. Të investohet në rrjetin elektrik dhe të rregullohet një trafo elektrike e cila është duke u rrëzuar. Kjo trafo paraqet rrezik për banorët, pasi ndodhet pranë rrugës.

Fshati Përqevë

Fshati Përqevë ka rreth 1100 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në fshatin Përqevë nuk është e mirë. Vetëm rruga kryesore që lidhet me Klinë është e asfaltuar, kurse rruga Përqevë-Sfërkë dhe rrugët lokale nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Fshati ka një shkollë fillore. Megjithatë, shkolla është e vjetër dhe kushtet për zhvillimin e mësimin në shkollë nuk janë të mira;

- ❖ Fshati nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Fshati Përqevë nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Fshati nuk ka ambulancë. Në mungesë të rrugës Përqevë-Sfërkë banorët për shërbime mjekësore duhet të udhëtojnë nga 13 km deri në Klinë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të fshatit Përqevë

1. Të asfaltohet rruga Përqevë - Sfërkë.
2. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
4. Të ndërtohet shkolla e re fillore. Shkolla ekzistuese është e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin.
5. Të ndërtohet ambulanca. Banorët kanë marrë premtimin nga Komuna se ambulanca do të ndërtohet.
6. Të mblidhen mbeturinat.

Fshati Dush

Fshati Dush ka rreth 400 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatit Dush nuk është e mirë. Vetëm rruga kryesore deri në hyrje të fshatit është e asfaltuar, kurse rrugët tjera nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Fshati Dush nuk ka shkollë fillore. Nxënësit vijnë në mësimin në fshatin Sfërkë;
- ❖ Fshati është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Fshati Dush nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Fshati nuk ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të fshatit Dush

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
2. Të asfaltohet rruga rreth 1 km. brenda fshatit.
3. Të mblidhen mbeturinat.

Fshati Qypevë

Fshati Qypevë ka 300 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në fshatin Qypevë nuk është e mirë. Vetëm një pjesë e rrugës kryesore është e asfaltuar;

- ❖ Fshati nuk ka shkollë fillore. Nxënësit vijnë në mesimin në fshatin Voljakë, që ndodhet rreth 3 km. larg nga fshati;
- ❖ Fshati është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë ka dy vite që ky rrjet nuk funksionon;
- ❖ Fshati Qypevë nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Fshati nuk ka ambulancë. Për shërbime mjekësore banorët udhëtojnë nga 4 km deri në fshatin Shtërkë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të fshatit Qypevë

1. Të sigurohet transporti për nxënësit. Nxënësit udhëtojnë nga 3 km. për të vijuar mesimin në shkollën e fshatit Voljakë.
2. Të vihet në funksion rrjeti i ujësjellësit.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
4. Të asfaltohet rruga.
5. Të ndërtohet trotuari dhe të vendosen shenjat sinjalizuese.
6. Të ndërtohet një çerdhe e fëmijëve në fshatin Qypevë ose në Voljakë.
7. Të mblidhen mbeturinat.

Fshati Voljakë

Fshati Voljakë ka 1000 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në fshatin Voljakë është mesatarisht e mirë. Vetëm rruga kryesore është e asfaltuar, kurse rrugët lokale të fshatit nuk janë të asfaltuara. Gjithashtu, në hyrje të fshatit rruga është shumë e rrezikshme për automjete, sepse nuk ka anësore dhe mungojnë pasqyret sinjalizuese;
- ❖ Fshati ka një shkollë fillore, në të cilën vijnë në mesimin 287 nxënës. Shkolla është renovuar këtë vit, megjithatë në shkollë mungon inventari;
- ❖ Fshati është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Fshati Voljakë nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Fshati nuk ka ambulancë;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të fshatit Voljakë

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
2. Të ndërtohet trotuari në rrugën Qypevë-Gremnik dhe gjithashtu trotuari në aksin rrugor për Gjakovë.
3. Të asfaltohen rrugët brenda fshatit.
4. Të mblidhen mbeturinat.

Zyra e Vëndit Shtupel

Zyra e vëndit Shtupel përfshin pesë fshatra: Shtupel, Kërnice, Bingjë, Grapc dhe Dranashiq, në të cilat fshatra jetojnë 1630 banorë.


Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore në fshatrat e kësaj zyreje të vëndit nuk është e mirë. Rrugët kryesore të fshatrave janë kryesisht të paasfaltuara;
- ❖ Zyra e Vëndit ka një shkollë fillore në fshatin Shtupel dhe një paralele të ndarë në fshatin Kërnice, në të cilat vijnë mësimin 470 nxënës. Kushtet për zhvillimin e mësimin në shkollë janë të mira;
- ❖ Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por uji nuk është i pijshëm;
- ❖ Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Zyra e Vëndit Shtupel ka një ambulancë në fshatin Shtupel. Largësia e banorëve të fshatrave të tjerë për të marrë shërbime mjekësore në këtë ambulancë është nga 3 – 4 km.;
- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave nuk bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të Zyrës së Vëndit Shtupel

1. Të asfaltohet rruga kryesore Shtupel – Klinë dhe rruga Shtupel – Ranoc – Zllakuqan - Klinë.
2. Të pastrohet uji i pijes. Fshatrat janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por uji nuk është i pijshëm
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
 1. Të investohet në rrjetin elektrik, sepse rrjeti ekzistues është shumë i dobët.
 2. Të mblidhen mbeturinat nga Komuna.
 3. Të ofrohen shërbime më të mira mjekësore në ambulancë.

KOMUNA E JUNIKUT



Harta e Junikut

Juniku është Komunë e re dhe bën pjesë në grupin e komunave të vogla të Kosovës e formuar sipas udhëzimit administrativ 2005/11 mbi pilot njësitë komunale. Juniku është certifikuar si Komunë nga data 13.08.2008.

Komuna e Junikut ka një territor me sipërfaqe prej 77,7 km². Duke u mbështetur në të dhënat statistikore të vitit 1981 dhe disa regjistrimeve lokale që janë bërë pas luftës, vlerësohet që Komuna Junikut ka 9.600 banorë.

Komuna e Junikut shtrihet në veriperëndim të luginës së plleshme të Dukagjinit, para grykës piktoreske të lumit Erenik, i cili gjarpëron nëpër lugjet e Alpeve Shqiptare. Juniku ka tipe të ndryshme peisazhesh, nga ai hidrografik (lumenjtë Erenik dhe Travë), peisazhe fushore (fusha e Junikut) dhe peisazhe kodrinore apo malore (Gjeravica, Moronica). Kuvendi Komunal i Junikut ka shpallur Moronicën “zonë të vecantë të Komunës së Junikut”. Kjo zonë mendohet të jetë “parku i ardhshëm i qytezës që do të jetë si urë lidhëse në mes të parkut etnografik dhe parkut nacional të Bjeshkëve të Nemuna”. Komuna e Junikut kufizohet me komunën e Deçanit, Gjakovës dhe në pjesën veriore kufizohet me Shqipërinë. Pozita gjeografike e Junikut, karakteristikat topografike dhe veçoritë natyrore përveç që e lidhin komunën e Junikut me ato fqinje, paraqesin njëherit edhe fusha me interes të përbashkët dhe mundësi për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar.

Komuna e Junikut përbëhet prej fshatrave: Jasiq dhe Gjocaj dhe lagjeve: Lagja Hoxhaj, Lagja Berishë, Lagja Çoku – Krasniq, Lagja Miroc – Malok, Lagja Gaxherr i ulët, Lagja Gaxherr i epërm, Lagja Gacafer, Lagja Bajraktar, Lagja Pepsh, Goçaj dhe Lagja Agim Ramadani.

PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË JUNIKUT

Rekomandimet e përgjithshme të banorëve të komunës së Junikut

1. Të vendoset rrjeti i kanalizimit. Vetëm 50% e banorëve të komunës së Junikut janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit.
2. Të vendoset kanali i ujitjes së tokave bujqësore.
3. Të mblidhen mbeturinat nga komuna dhe të punohet në vetëdijësimin e qytetarëve për pagesën e mbledhjes së mbeturinave. Për shkak të mospagesës, mbeturinat mblidhen vetëm në qendër dhe në disa pjesë ku banorët bëjnë pagesën.
4. Të bëhet riparimi i rrjetit elektrik. Në komunën e Junikut rrjeti elektrik është shumë i dobë. Ky rrjet është vendosur në vitet e 70-ta.
5. Të bëhet ndriqimi i lagjeve. Veç qendrës së Junikut asnjë nga lagjet e Junikut nuk ka ndriqim publik.
6. Të pastrohet lumi Erenik dhe të vendoset muroja.
7. Të ndërtohet një çerdhe e fëmijëve.
8. Të kalohet në kompetencë të komunës menaxhimi i pyjeve, sepse ka dëmtime të mëdha të pyjeve. Ato prehen në mënyrë ilegale.
9. Të investohet në zhvillimin e turizmit, bujqësisë dhe blegtorisë dhe të ndërtohen hidrocentrale. Në komunën e Junikut mund të ndërtohen 3 mini hidrocentrale.
10. Të ndërtohet rruga për bjeshkë: Junik- Lugu i gjatë. Kjo rrugë do të ndihmonte edhe në zhvillimin e turizmit veror dhe atij dimëror.
11. Të ndërtohet një fontanë në qendër të Junikut.
12. Të vendosen gardhet ndarëse në mes tokave ose arave të fshatit.

JUNIKU - Qendra

Qendra e Junikut ka 110 shtëpi

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e qendrës së Junikut është kryesisht e mirë. Megjithatë, 3 rrugë anësore nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Juniku ka një shkollë fillore në lagjen e qendrës dhe një shkollë të mesme në lagjen Pepsh. Shkolla fillore, në të cilën vijojnë mësimin 800 nxënës ka 2 objekte. Shkolla është ndërtuar para vitit 1999 dhe kushtet në shkollë janë mesatarisht të mira. Megjithatë, shkolla nuk ka nxemje qendrore dhe nuk ka sallë sportive;
- ❖ Qendra e Junikut është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ 50% e shtëpive të kësaj pjese janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Juniku ka një QMF - Qendër të Mjekësisë Familjare, por e cila funksionon në objektin e Qendrës për Punë Sociale. Objekti i QMF-së është ndërtuar pas vitit 1999, por lokacioni nuk ka qenë i përshtatshëm dhe ky objekt më pas është rrënuar. Banorët kanë marrë premtimin nga Komunal se ky objekt do të ndërtohet;
- ❖ Qendra e Junikut ka ndriqim;

- ❖ Shërbimet komunale si pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave në këtë pjesë bëhen nga komuna.

Rekomandimet e banorëve të qendrës së Junikut

1. Të lirohen trotualet nga automjetet.
2. Të asfaltohet rruga tranzit prej lagjes Bajraktar, Bajram Curr dhe rruga kryesore Junik-Rastavicë.



Kryetari i Komunës së Junikut z. Agron Kuqi gjatë takimit në Junik

Lagja Goqaj

Lagja Goqaj ka 28 shtëpi.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e lagjes nuk është e mirë. Lagja ka 3 rrugë të cilat janë të shtruara me zhavor;
- ❖ Lagja nuk është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Për ta zgjidhur këtë çështje banorët kanë bërë disa herë kërkesë në komunë;
- ❖ Lagja nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Lagja Goqaj nuk ka ndriqim.

Rekomandimet e banorëve të lagjes Goqaj

1. Të vendoset rrjeti i ujësjellësit.
2. Të kthehet në planin rregullativ lagja Goqaj (të bëhet interpretimi i drejtë i antropogeografisë për lagjen Goqaj).
3. Të shqyrtohet çështja e stemës së komunës nga Kuvendi Komunal.

Lagja Berishë

Lagja Berisha ka 160-170 shtëpi

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e lagjes nuk është e mirë. Lagja ka 6 rrugë dhe asnjëra prej tyre nuk është e asfaltuar. Rrugët janë të shtruara me zhavor;
- ❖ Lagja Berisha është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por rreth 200 metra të gypave të ujësjellësit janë të azbestit;
- ❖ Lagja nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;

Rekomandimet e banorëve të lagjes Berisha

1. Të shtrohet me kubëza rruga që lidhet me rrugën kryesore, që shkon për Dobrosh dhe Botushë.
2. Të ndërrohen gypat e ujësjellësit.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.



Takim me përfaqësuesit e Shoqërisë Civile dhe zyrtarët e Komunës së Junikut

Lagja Çoku-Krasniq

Lagja Çoku-Krasniq ka 100 familje, megjithatë rreth 40 % prej tyre jetojnë jashtë vendit.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e lagjes nuk është e mirë. Lagja ka një rrugë kryesore dhe dy rrugë lokale të cilat nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por në një pjesë të lagjes janë vendosur gypa të azbestit. Banorët kanë marrë premtimin nga Komuna se këto gypa do të ndërrohen;
- ❖ Lagja nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit. Banorët gjithashtu kanë marrë premtimin nga Kuvendi Komunal se do të vendoset rrjeti i kanalizimit.

Rekomandimet e banorëve të lagjes Çoku-Krasniq

1. Të ndërrohen gypat e ujësjellësit.
2. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
3. Derisa nuk asfaltohet rruga kryesore, të paktën të mirëmbahet me zhavorr.
4. Të përfundojë asfaltimi i rrugës prej mullirit deri te shkolla fillore. Kjo rrugë ka filluar të ndërtohet vitin e kaluar, por nuk ka përfunduar. Asfaltimi i kësaj rruge do të shkurtojë rrugën për nxënësit dhe do të jetë me më pak rrezik për ta.
5. Të asfaltohet rruga prej lagjes Bajraktar - lagja Çok dhe të lidhet me rrugën kryesore Restovicë - Junik.
6. Të rregullohet kanali për ujitjen e tokave bujqësore që kalon nëpër lagjet Bajram Curr, Miroc, Shalë dhe Gaxherr.
7. Të vendoset sistemi i ujitjes së tokave bujqësore.

Fshati Jasiq

Pas vitit 1999 fshati Jasiq nuk është i banueshëm, ndërkohë që para këtij vitit ka pasur 300 banorë. Një nga arsyet kryesore që banorët kanë braktisur fshatin ka qenë se deminimi është bërë pjesërisht. Banorët shprehen se ata do të kthehen në fshat nëse bëhet deminimi dhe u ofrohen kushte më të mira jetese.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e fshatit nuk është e mirë. Fshati ka një rrugë kryesore dhe tri rrugë lokale të cilat nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Fshati ka patur një shkollë fillore, por e cila është shkatërruar gjatë luftës;
- ❖ Fshati nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Fshati gjithashtu nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit;
- ❖ Fshati ka patur një ambulancë, por e cila është shkatërruar gjatë luftës.

Rekomandimet e banorëve të fshatit Jasiq

1. Të bëhet deminimi i fshatit. Ndonëse në fshat është bërë deminimi ai nuk ka përfunduar në tërësi. Ekzistimi i minave është arsyeja kryesore e moskthyerjes së banorëve në fshat.
2. Të rindërtohet shkolla, e cila është shkatërruar gjatë luftës.
3. Të rindërtohet ambulanca, e cila gjithashtu është shkatërruar gjatë luftës.

Fshati Gjocaj

Fshati Gjocaj ndodhet afër fshatit Jasiq, i cili gjithashtu është i pabanueshëm. Para vitit 1999 fshati ka patur 300-400 banorë. Arsyet e moskthimit të banorëve në fshat janë po ato të fshatit Jasiq, pasi të dy fshatrat kanë patur të përbashkët shkollën dhe ambulancën.

Shumica e banorëve të fshatrave Jasiq dhe Gjocaj jetojnë në lagjen Agim Ramadani. Megjithatë, edhe në këtë lagje banorët ballafaqohen me kushte jo të mira jetese. Kërkesë e përbashkët e banorëve të të dy fshatrave është që derisa nuk bëhen investime në fshatrat e tyre, të paktën t'u krijohen kushte më të mira jetese në lagjen Agim Ramadani.

Lagja Agim Ramadani

Lagja Agim Ramadani ka 130 shtëpi

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e lagjes nuk është e mirë. Lagja ka një rrugë kryesore, e cila nuk është e asfaltuar dhe është në gjendje shumë të keqe;
- ❖ Lagja nuk ka shkollë fillore. Rreth 100 nxënës të kësaj lagjeje udhëtojnë rreth 3 km. deri në shkollën fillore në Junik;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por uji është shumë i ndotur dhe nuk preferohet për pije;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e kanalizimit;

Rekomandimet e banorëve të lagjes Agim Ramadani

1. Të asfaltohet rruga e lagjes.
2. Të bëhet pastrimi-klorizimi i ujit, sepse uji nuk preferohet për pije.
3. Të vendoset ndriqimi në lagje.
4. Të sigurohet transporti për nxënësit dhe gjithashtu të hapet një paralele për nxënësit parashkollor.

Lagja Gacafer

Lagja Gacafer ka 100 shtëpi.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Infrastruktura rrugore e lagjes nuk është e mirë. Lagja ka një rrugë, e cila nuk është e asfaltuar;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por gypat e ujësjellësit janë të azbestit;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e kanalizimit.

Rekomandimet e banorëve të lagjes Gacafer

1. Të ndërrohen gypat e ujësjellësit.
2. Të asfaltohet rruga e lagjes.

Lagja Gaxherr

Lagja Gaxherr 300 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Lagja ka një rrugë kryesore, e cila është e asfaltuar dhe një rrugë lokale të shtruar me zhavor;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por 7-8 shtëpi nuk janë të lidhura me këtë rrjet;
- ❖ Lagja nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit, por banorët kanë marrë premtimin nga Komuna se ky rrjet do të vendoset.

Rekomandimet e banorëve të lagjes Gaxherr

1. Të vazhdohet të rregullohet trotuari prej lagjes Gaxherr deri te lagja Agim Ramadani, sepse nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet.
2. Të sigurohet transporti për nxënësit.

Lagja Qestaj

Lagja Qestaj ka 35 shtëpi.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Lagja ka një rrugë kryesore, e cila është e asfaltuar dhe dy rrugë lokale të cilat nuk janë të asfaltuara;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, veç 5 shtëpive që janë afër lagjes Goqaj nuk janë të lidhura me këtë rrjet;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e kanalizimit, veç disa shtëpive që janë afër lagjes Goqaj nuk janë të lidhura me këtë rrjet. Banorët kanë marrë premtimin nga Komuna se kjo çështje do të rregullohet.

Rekomandimet e banorëve të Lagjes Qestaj

1. Të rregullohet ura për mbikalimin e lumit Erenik.
2. Të pastrohet lumi Erenik që kalon pranë lagjes.
3. Të rregullohen 2 rrugët lokale.
4. Të rregullohet ndriqimi i lagjes.

Lagja Miroc - Malok

Lagja ka 50 shtëpi në Miroc dhe 50 shtëpi në Malok.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Lagja ka një rrugë kryesore, e cila është e asfaltuar dhe një rrugë lokale e cila nuk është e asfaltuar;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Lagja nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit.

Rekomandimet e banorëve të Lagjes Miroc-Malok

1. Të përfundohet rrjeti elektrik. Shtyllat elektrike janë vendosur por nuk janë në funksion.
2. Të asfaltohet rruga anësore.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
4. Të bëhet ndriqimi i lagjes.

Lagja Pepsh

Lagja Pepsh ka 200 banorë.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Lagja gjendet pranë rrugës që lidh fshatrat Gjocaj – Jasiq, por e cila rrugë është e paasfaltuar dhe gjithashtu nuk ka trotuar;
- ❖ Lagja Pepsh ka një shkollë të mesme, në të cilën vijojnë mësimin 300-400 nxënës të gjithë komunës së Junikut. Kjo shkollë është ndërtuar vitin e kaluar nga Ministria e Arsimit. Kushtet në shkollë janë të mira, megjithatë shkolla nuk ka sallë sportive;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit;
- ❖ Lagja nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit.

Rekomandimet e banorëve të Lagjes Pepsh

1. Të asfaltohet rruga dhe të rregullohet trotuari.
2. Të investohet në rrjetin elektrik dhe gjithashtu të bëhet ndriqimi i lagjes.
3. Të vendoset sistemi i ujitjes së tokave bujqësore.
4. Të rregullohet fusha sportive, e cila më parë është shfrytëzuar nga të gjithë banorët për aktivitete sportive.

Lagja Bajraktari

Lagja Bajraktari ka 30 shtëpi.

Pasqyra e përgjithshme:

- ❖ Lagja Bajraktari ka një rrugë kryesore, e cila është e paasfaltuar. Kjo rrugë i lidh lagjet Bajram Curr dhe Gaxherr;
- ❖ Lagja është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por sasia e ujit të pijes gjatë verës nuk është e mjaftueshme për banorët;
- ❖ Lagja nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit.

Rekomandimet e banorëve të Lagjes Bajraktari

1. Të asfaltohet rruga kryesore.
2. Të bëhet ndriqimi i lagjes.
3. Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
4. Të ketë furnizim të mjaftueshëm me ujë.
5. Të investohet në rrjetin elektrik.

Regjioni i Pejës: Pejë, Gjakovë, Deçan, Istog, Klinë, Junik
Kërkesat dhe rekomandimet e qytetarëve

Informata shtesë

1. Informacioni i përdorur në pjesët hyrëse për secilën komunë është marrë nga web-faqja e komunave.
2. Prioritetet e përmbledhura dhe publikuara në këtë publikim janë mbledhur gjatë periudhës mars - gusht 2010.

ATRC falenderon përfaqësuesit e Komunës së Pejës, Gjakovës, Deçanit, Istogut, Klinës dhe Junikut, përfaqësuesit e Bashkësive Lokale, Zyrtarët e Vendlit dhe përfaqësuesit e fshatrave të regjionit të Pejës për përkrahjen gjatë implementimit të aktiviteteve në terren, si dhe një falenderim i veçantë për të gjithë qytetarët e regjionit të Pejës, të cilët kontribuan në përpilim e këtij dokumenti, pa ndihmën e të cilëve nuk do të ishte i mundur të arriheshin rezultatet e synuara.

Projekti u financua nga The Olof Palme International Center





Advocacy Training and Resource Center

Rr. Gazmend Zajmi, Nr. 20

Prishtinë, Kosovë

Tel/fax: +381 38 244 810

info@advocacy-center.org

www.advocacy-center.org